


BËSIMI NË QEVERISJE SONDAZHI I OPINIONIT PUBLIK 2023



Institute
for Democracy
and Mediation

With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



SONDAZHI I OPINIONIT PUBLIK 2023: BESIMI NË QEVERISJE

Autorë:

Blerina Metanj (Subashi)

Besjana Kuçi

Diori Angjeli

Koordinatorë e punës në terren:

Sheila Hafizi

© Dhjetor 2023 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

www.idmalbania.org

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit "Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri" (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribuues kryesor, bashkë me UNDP-në. Brenda e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të qeverisë shqiptare, UNDP-së, apo ADC-së.

BESIMI NË QEVERISJE 2023

PËRMBLEDHJE








Edicioni i **njëmbëdhjetë** i Sondazhit të Opinionit “Besimi në Qeverisje” u realizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë muajve tetor-nëntor 2023 në 61 bashkitë e Shqipërisë, duke përdorur një kampion të përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe përfaqësues kombëtar prej 2500 qytetarësh.

Nëpërmjet këtij sondazhi synohet të bëhet një vlerësim i perceptimeve dhe qëndrimeve të publikut, me gjasa të ndikuar nga një sërë faktorësh, si zgjedhjet vendore që u mbajtën në maj 2023, zhvillimet politike pas zgjedhjeve dhe përçarjet e dukshme brenda opozitës. Ndonëse korrupsioni vazhdon të jetë një sfidë, hapat e ndërmarrë për ta luftuar atë si dhe hetime penale ku përfshihen figura të profilit të lartë si ish-ministra dhe anëtarë të parlamentit mund të kenë formësuar opinionin publik.

Ndërkohë, përparimi drejt anëtarësimit në BE mund të ketë ndikuar te perspektivat mbi qeverisjen dhe llogaridhënien. Duhet theksuar se një vit pas fillimit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, Komisioni Evropian publikoi Raportin e parë të Shqyrtimit për Shqipërinë, duke theksuar përparimin e vendit drejt anëtarësimit në BE.

Gjetjet kryesore
të sondazhit
të opinionit
grupohen në

7 kapituj kryesorë >>





BESIMI NË INSTITUCIONE

- Organizatat ndërkombëtare, si NATO (76.7%), OKB (74.3%) dhe BE (74.7%), ruajtën pozicionet e tyre si institucionet më të besuara në Shqipëri në sondazhin e vitit 2023.
- Institucionet fetare (67%) mbetën institucionet vendase më të besuara, të ndjekura nga Prokuroria e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) (60.3%) dhe organizatat e shoqërisë civile (55.7%).
- Partitë politike (25.5%), parlamenti (29.1%), gjykatat (33.4%) dhe prokuroria (33.7%) renditen si institucionet më pak të besuara në vitin 2023. Partitë politike dhe parlamenti pësuan një rënie prej 5 pikë përqindje në krahasim me vitin e kaluar, ndërkohë që gjykatat pësuan një rënie prej 3 pikë përqindjeje. Gjithsesi, prokuroria pati një rritje të lehtë (1 pikë përqindje) gjatë së njëjtës periudhë. Po ashtu, besimi i publikut te presidenti ka rënë me 6 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë.
- Prokuroria e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), e përfshirë në sondazh për herë të parë në vitin 2022, shënoi një rritje të konsiderueshme prej 10 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë.
- Gjysma e të anketuarve (50.2%) janë plotësisht ose përgjithësisht dakord se sistemi i reformuar i drejtësisë në Shqipëri po kontribuon pozitivisht në zhvillimin e vendit. Në krahasim tjetër, rreth 44.9% e qytetarëve nuk ishin dakord ose aspak dakord me këtë pohim.



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

- Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar (59% për qeverinë qendrore dhe 60.2% për qeverisjen vendore) mendojnë se të dy nivelet e qeverisjes kanë mungesë transparence.
- Një përqindje e ngjashme e të anketuarve mendonin se këto institucione nuk kanë kërkesë llogarie (62.7% për qeverinë qendrore dhe 59.3% për qeverisjen vendore).
- Nivelet e perceptimit të transparencës dhe llogaridhënies si në qeverinë qendrore ashtu edhe në atë vendore nuk ndryshonin ndjeshëm nga rezultatet e vitit 2022. Organizatat ndërkombëtare (69.4%) mendohet se i kërkojnë llogari qeverisë qendrore më shumë në krahasim me institucionet vendase të listuara, duke ruajtur të njëjtin rezultat me një vit më parë (70.4%).
- Kontrolli i Lartë i Shtetit konsiderohet si institucioni vendas më efektiv për llogaridhënien e qeverisë (58.6%), ndjekur nga parlamenti (49.5%), ndonëse të dy këto institucione pësuan një rënie të konsiderueshme në krahasim me vitin 2022 (-5 p.p. për KLSH-në dhe -9 p.p. për parlamentin).



KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE

- Në vitin 2023, shumica e pjesëmarrësve (81.3%) thanë se e konsiderojnë korrupsionin e vogël si "të përhapur" ose "shumë të përhapur" në Shqipëri. Po ashtu, për korrupsionin e madh, 81.5% e të anketuarve e konsiderojnë atë si "të përhapur" ose "shumë të përhapur". Të dy rezultatet kanë një ndryshim të vogël në krahasim me vitin 2022, me një 4.8 p.p. rritje për korrupsionin e vogël dhe një 2.4 p.p. rritje për korrupsionin e madh.
- 62.8% e shqiptarëve thanë se u mungonte besimi tek aftësia e prokurorisë për të trajtuar rastet e korrupsionit të madh. Po ashtu, 56.8% shprehën mungesë besimi

në ndjekjen me efektivitet të rasteve të korrupsionit të vogël. Këto shifra pasqyrojnë të dhënat e vitit 2022, ku 65.8% nuk i besojnë prokurorisë për të ndjekur penalisht korrupsionin e vogël dhe 56.9% nuk kanë besim në aftësinë e prokurorisë për të trajtuar rastet e korrupsionit të madh.

- 14.7% e shqiptarëve raportojnë se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel të qeverisjes qendrore dhe 21.6% raportojnë të kenë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel vendor. Sërish, këto shifra janë të ngjashme me ato të sondazhit të vitit 2022.
- 29.9% e qytetarëve që kanë marrë shërbime nga qeverisja vendore në vitin 2023 raportojnë të kenë paguar ryshfet për zyrtarët publikë të këtij niveli. Pothuajse e njëjta përqindje (29.8%) e qytetarëve që kanë marrë shërbim nga qeveria qendrore në 2023 thanë se kanë paguar ryshfet te zyrtarët publikë të këtij niveli qeverisjeje.
- Për sa i përket arsyeve për dhënien e ryshfetit, 57.8% kanë raportuar se u ishte kërkuar, 21.7% kanë thënë se kanë paguar për të marrë shërbime më të mira herën tjetër, ndërsa 14.8% kanë paguar si mirënjohje për shërbimet e marra.
- Mes të anketuarve që kanë paguar ryshfet, vetëm 10.9% e kanë raportuar atë tek autoritetet. Arsytet që u përmendën më shpesh për mosraportim ishin: 39% e konsideronin ryshfetin si praktikë të zakonshme, 32.2% e mendonin denoncimin si të padobishëm dhe 8.3% kishin frikë nga hakmarrja.



PJESËMARRJA QYTETARE

- Në vitin 2023, përqindja e shqiptarëve të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrje ka qëndruar pothuajse e njëjtë (43.2%) në krahasim me vitin 2022 (45.3%).
- Një përqindje e vogël e qytetarëve të anketuar raportojnë se kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen qendrore (27.3%), ndërkohë që një përqindje paksa më e madhe i konsideronin mundësitë më të përshtatshme për pjesëmarrje në vendimmarrjen vendore (36.9%), ku të dy nivelet mbeten pothuajse të qëndrueshme në krahasim me vitin 2022.
- Në vitin 2023, 10.9% e shqiptarëve të anketuar ishin ftuar të angazhoheshin në proceset e konsultimit të qeverisë qendrore, ndërsa një përqindje më e lartë, 18.5%, kishin marrë ftesa për konsultime në nivel vendor. Pavarësisht luhatjeve në përqindjet e ftesave, pjesëmarrja aktuale ka mbetur vazhdimisht e ulët gjatë viteve, përgjithësisht nën 25%.
- Në 2023, 14.4% e të anketuarve thanë se kishin përdorur portalin www.konsultimipublik.gov.al për të marrë informacione apo për të dhënë mendime për projektligjet apo strategjitë, më pak se në vitin 2022 (18.1%).
- Përqindja e popullsisë që ka marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo që ka nënshkruar një peticion pësoi një rënie, nga 32.2% në 2022 në 25.2% në 2023.
- Gatishmëria e qytetarëve shqiptarë të anketuar për t'u angazhuar në punë vullnetare në komunitet ka pësuar një rënie të lehtë në 58.6% nga 61.5% në 2022.
- Rreth 38.3% e shqiptarëve të anketuar shprehën dëshirën për të emigruar në vitin 2023, duke përmendur arsye të tilla si punësimi, paga më të larta jashtë vendit dhe ndjekja e arsimit më të mirë. Kjo gjetje është e njëjtë si tendencë me atë të vitit 2022.
- Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme u ul ndjeshëm, me 67.6% që ndiheshin të pasigurt në vitin 2023 (me rritje nga 59.3% në 2022). Shkaqet kryesore të ndjenjës së pasigurisë ishin krimi, problemet shëndetësore dhe pasiguria për vendin e punës.

- Kur u pyetën për prioritetet e qeverisë për pesë vitet e ardhshme, të anketuarit theksuan kujdesin shëndetësor (54%) dhe arsimin (38%) si fusha të rëndësishme që duan vëmendje, ndjekur nga turizmi, infrastruktura e transportit dhe bujqësia.



OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

- Mesatarisht, katër nga dhjetë qytetarë (39.3%) thanë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë, nivel ky i ngjashëm me atë të vitit 2022.
- Niveli i kënaqshmërisë ndryshonte në shërbime të ndryshme, ku furnizimi me ujë (47.2%), shërbimi i pastrimit (47.3%), arsimi (46.2%) dhe shërbimet shëndetësore publike (44%) kanë marrë vlerësime më të larta në krahasim me shërbimin e policisë (35.4%), transportin publik (31.8%) dhe shërbimet gjyqësore (25.5%).
- Mes qytetarëve shqiptarë që kishin përdorur një shërbim administrativ në 2023, 59% thanë se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimin, veçanërisht kur bëhej fjalë për gjendjen civile (71.6%), sigurimet shoqërore (66.7%), dhe transportin rrugor (68.3%).
- Në vitin 2023, 20.9% e qytetarëve shqiptarë kanë përdorur platformën online të bashkëqeverisjes 'www.shqiperiaqeduam.al' për të bërë ankesë, duke treguar një rritje të madhe nëse i krahasojmë me të dhënat e vitit 2022 (9.5%). Ndër ata që bënë një ankesë, 30.3% raportuan se ankesa e tyre ishte trajtuar.
- Për vitin 2023 raportohet një nivel i lartë ndërgjegjësimi për shërbimet elektronike të ofruara nga e-Albania, me 92% të të anketuarve. Ndër ta, në vitin 2023 75.6% kanë përdorur shërbimet e kësaj platforme. Shumica e përdoruesve e konsideruan e-Albania si funksionale (84.7%), dhe 59.7% thanë se u ofron qytetarëve mundësinë për të marrë ndihmën që u nevojitet. Megjithatë, më pak se gjysma menduan se kjo platformë ofron mundësi për të shprehur mendime dhe sugjerime.
- Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve që kanë përdorur portalin e-Albania thanë se mund ta bënin këtë në mënyrë të pavarur, duke përbërë kështu 45.4%. Nga ana tjetër, 22.2% thanë se rrallë merrnin ndihmë nga të tjerët. Ndërsa 18.8% thanë se zakonisht e përdorin me ndihmë nga dikush tjetër dhe 13.6% e përdorin gjithmonë me ndihmë nga dikush tjetër.
- Shumica dërrmuese e të anketuarve mendonin se mbrojtja e të dhënave të tyre personale ishte e rëndësishme ose shumë e rëndësishme (90.7%). 35% besonin në aftësinë e aktorëve publikë për të menaxhuar të dhënat personale elektronike dhe 30.8% thanë të njëjtën gjë për sektorin privat.



NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKE

- Gjykatat (35.5%) dhe prokuroria (35.3%) konsiderohen si institucionet më të ndikuara politikisht nga të gjitha institucionet, ndonëse me një përmirësim në krahasim me vitin 2022 (përkatësisht 41.8% dhe 38.6% e të anketuarve.).
- Krahasuar me vitin 2022, është përmirësuar perceptimi për ndikimin e politikës të të gjitha institucionet, ku mediat (-9 p.p.), SPAK (-8 p.p.) dhe gjykatat (-7 p.p.) patën ndryshimet më të mëdha pozitive.
- Institucionet fetare konsiderohen si institucionet më pak të ndikuara politikisht (me vetëm 7.8% të qytetarëve që i konsiderojnë ato si "shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara"), shifër më e ulët se ajo e vitit 2022 (12.4%).



PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE

- 59.4% e shqiptarëve janë dakord se në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave, me një rënie të lehtë krahasuar me në vitin 2022 (61.5%).
- Shumica e të anketuarve (77.6%) besojnë se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë tek shërbimet publike, përqindje që është mjaft e ngjashme me atë të vitit të kaluar (77.1%).
- Rreth $\frac{3}{4}$ e shqiptarëve (71.1%) besojnë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave, një përqindje paksa më e ulët se në 2022 (72.4%).
- Në vitin 2023, 14.3% e shqiptarëve raportojnë se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, statusit me aftësi të kufizuar, apo për arsye të tjera, pothuajse e njëjta përqindje si në vitin 2022 (14.6%).
- Të dhënat e tre viteve të fundit (2021-2023) tregojnë se përgjithësisht më shumë se gjysma e shqiptarëve janë dakord se ka barazi mes burrave dhe grave në shoqëri. Burrat kishin më shumë gjasa në krahasim me gratë të shpreheshin dakord se në vend ka barazi gjinore, me një mesatare prej 65%, krahasuar me 56% për gratë.
- Gjatë periudhës në fjalë, shumica e shqiptarëve besojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtën akses tek shërbimet publike dhe se nëpunësit publikë u shërbejnë grave dhe burrave me të njëjtën etikë dhe përkushtim.
- Gjatë viteve 2021-2023, përqindja e shqiptarëve që raportuan se trajtoheshin ndryshe nga një institucion ose zyrtar publik për shkak të aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, përkatësisë etnike, moshës, gjinisë ose për arsye të tjera nuk ka ndryshuar ndjeshëm. Vlerat varionin nga 11.8% në 14.3%.

Përmbajtja

1.	HYRJE	13
2.	METODOLOGJIA	14
2.1	METODOLOGJIA STATISTIKORE DHE PËRSHKRIMI STATISTIKOR I KAMPIONIT	14
2.2	INSTRUMENTI I SONDAZHIT	15
2.3	MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE	16
3.	DEMOGRAFIA E KAMPIONIT	17
	REZULTATET E SONDAZHIT TË OPINIONIT	21
4.	BESIMI NË INSTITUCIONE	23
5.	TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA	34
6.	KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE	46
7.	PJESËMARRJA QYTETARE	57
8.	OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE	70
9.	NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKE	83
10.	PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE	88
	SHTOJCA 1: KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT (2013–2023)	93

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Përfaqësimi gjinor	17
Figura 2. Përfaqësimi sipas vendbanimit	17
Figura 3. Përqindja e të anketuarve sipas grupmoshës	17
Figura 4. Niveli i arsimit të përfunduar	18
Figura 5. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto)	19
Figura 6. Besimi në institucione (2023)	24
Figura 7. Perceptimi për ndikimin pozitiv të sistemit të reformuar të drejtësisë në zhvillimin e vendit (2023)	26
Figura 8. Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin në 2023	27
Figura 9. Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2023	28
Figura 10. Saktësia e mediave (2016–2023)	34
Figura 11. Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe asaj vendore (2023)	35
Figura 12. Perceptimi për llogaridhënien e qeverisë qendrore dhe vendore (2023)	36
Figura 13. Ndryshimi në perceptimin për transparencën e institucioneve 2016–2023	36
Figura 14. Ndryshimi në perceptimin për llogaridhënien e institucioneve 2016–2023	37
Figura 15. Përqindja e të anketuarve që janë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti (2023)	37
Figura 16. Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2023)	38
Figura 17. Përqindja e të anketuarve që janë në dijeni të faqes së internetit të bashkisë së tyre (2014–2023)	38
Figura 18. Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2016–2023)	39
Figura 19. Arsyet kryesore të përdorimit të faqes së internetit të bashkisë (me disa zgjedhje)	40
Figura 20. Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale (2023)	41
Figura 21. Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale (2023)	47
Figura 22. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit (2023)	48
Figura 23. Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 'I përhapur' ose 'Shumë i përhapur' (2019–2023)	48
Figura 24. Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2023)	49
Figura 25. Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2017–2023)	50
Figura 26. Besimi tek institucionet dhe strukturat publike kombëtare për trajtimin e rasteve të korrupsionit (2023)	51
Figura 27. Përvoja personale me korrupsionin (2023)	52
Figura 28. Përvoja personale me korrupsionin (2016–2023)	52
Figura 29. Shërbimet e marra në nivel qendror dhe vendor (2023)	53
Figura 30. Ryshfet paguar për shërbim – përdoruesit e shërbimeve në nivel qendror dhe vendor (2023)	54
Figura 31. Përqindja e përhapjes së ryshfetit (2016–2023)	55
Figura 32. Rastet e ryshfetit të raportuar tek autoritetet/institucionet (2023)	55
Figura 33. Arsyet e mosraportimit të korrupsionit në institucionet publike (2023)	57

Figura 34. Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike (2023)	58
Figura 35. Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2023)	58
Figura 36. Mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen (2016–2023)	59
Figura 37. Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2023)	59
Figura 38. Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016–2023)	60
Figura 39. Pjesëmarrja në takime konsultimi (2023)	61
Figura 40. Përdorimi i portalit “Konsultimipublik.gov.al” në vitin 2023	61
Figura 41. Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në vitin 2023	62
Figura 42. Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni (2016–2023)	62
Figura 43. Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare (2023)	63
Figura 44. Largimi nga vendbanimi aktual (2023)	64
Figura 45. Largimi nga vendbanimi aktual (2019–2023)	64
Figura 46. Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme (2016–2023)	71
Figura 47. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2023	71
Figura 48. Përqindja e të gjithë të anketuarve “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet publike bazë (2016–2023)	72
Figura 49. Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative 2023 (të gjithë të anketuarit)	73
Figura 50. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative: përdoruesit e shërbimeve dhe të gjithë të anketuarit (2019–2023)	74
Figura 51. Përqindja e të anketuarve që kishin bërë ankesë tek institucionet (2016–2023)	74
Figura 52. A keni bërë ndonjë ankesë tek platforma e bashkëqeverisjes ‘www.shqiperiaqeduam.al’ në vitin 2023?	75
Figura 53. Nëse keni bërë ankesë te ‘shqiperiaqeduam.al’, a është zgjidhur ajo? (2023)	75
Figura 54. Dijenia për shërbimet elektronike nëpërmjet portalit e-albania.al	76
Figura 55. A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania?	77
Figura 56. Vlerësimi i shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (2023)	78
Figura 57. Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave personale për qytetarët (2023)	78
Figura 58. Niveli i besimit në miradministrimin e të dhënave personale elektronike/ digjitale nga aktorët publikë përkundër sektorit privat (2023)	84
Figura 59. Perceptimi për ndikimin politik në programin e institucioneve (2023)	88
Figura 60. Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2023)	89
Figura 61. Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2016–2023)	90
Figura 62. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2023)	90
Figura 63. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2016–2023)	91
Figura 64. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2023)	91
Figura 65. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2016–2023)	91

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Popullsia rezidente më 1 janar 2023 dhe madhësia e kampionit për secilin qark	14
Tabela 2: Statusi i punësimit	18
Tabela 3: Përqindja e të anketuarve që i përkasin një pakice kombëtare	19
Tabela 4. Besimi në institucione në vite (2015–2023)	25
Tabela 5. Ndarja demografike e besimit ('kam shumë besim' dhe 'kam besim')	29
Tabela 6. Perceptimi për ndikimin e sistemit të reformuar të drejtësisë në zhvillimin e vendit (2023)	31
Tabela 7. Ndarja demografike e përdorimit të mediave (2023)	32
Tabela 8: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien (2023)	42
Tabela 9: Ndarja social-demografike për llogaridhënien horizontale dhe vertikale 2023)	43
Tabela 10: Arsyet për dhënien e rryshfetit (2023)	54
Tabela 11 Arsyet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2023	60
Tabela 12: Faktorët për ndjenjën e pasigurisë (2016–2023)	65
Tabela 13: Drejtimit kryesore për punën e qeverisë (2023) (me disa zgjedhje)	66
Tabela 14: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2023)	66
Tabela 15: Ndarja demografike e proceseve të konsultimeve në 2022—Vetëm përgjigjet e kategorisë "Po" (2023)	68
Tabela 16: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative (2023)	72
Tabela 17: Marrja shërbimeve nga portali e-Albania (2023)	76
Tabela 18: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë sipas grupeve demografike (2023)	79
Tabela 19: Ndarja demografike e nivelit të kënaqshmërisë së të gjithë të anketuarve të shërbimeve administrative 2023	80
Tabela 20. Ndarja demografike e nivelit të kënaqshmërisë vetëm të përdoruesve të shërbimeve administrative 2023	81
Tabela 21: Institucionet që perceptohen si "shumë të ndikuara" ose "jashtëzakonisht shumë të ndikuara" nga politika (2016–2023)	85
Tabela 22 Ndarja demografike e institucioneve të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht shumë (2023)	86
Tabela 23: Diskriminim nga institucioni (2023)	92

1. HYRJE

Në vitet e fundit, Shqipëria ka ndjekur reformat e institucioneve të saj demokratike, administratës publike, shtetit ligjor¹ dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim që të përafrohet me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Zbatimi i suksesshëm i këtyre reformave dhe fillimi i bisedimeve të anëtarësimit kanë një peshë të konsiderueshme në mënyrën se si publiku shqiptar e percepton qeverinë e tij. Këta faktorë, të kombinuar me besimin në qeverisje, ofrimin e shërbimeve publike dhe llogaridhënien, janë me rëndësi jetike në përcaktimin e mbështetjes ose kundërshtimit të shoqërisë ndaj situatës aktuale në Shqipëri.

Sondazhi i Opinioneve shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e besimit të publikut dhe angazhimit të qytetarëve në Shqipëri nga viti në vit. Objektivi kryesor i tij është të vlerësojë ndryshimin e pikëpamjeve të publikut për çështje si besimi, transparencë dhe llogaridhënia e institucioneve, përhapja e korrupsionit, përfshirja e qytetarëve në politikëbërje, kënaqësia me shërbimet publike dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jodiskriminuese. Për më tepër, ky instrument ofron të dhëna që përdoren për të mbështetur reforma të rëndësishme në qeverisje, në sistemin e drejtësisë, për masat kundër korrupsionit dhe për çështje ndërsektoriale si barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Në edicionin e tij të njëmbëdhjetë, raporti paraqet rezultatet e sondazhit të opinionit të vitit 2023 dhe tendencat kryesore ndër vite. Ky sondazh ka mbuluar vitet 2013 deri në 2023, duke përdorur të njëjtin instrument anketimi. Nën drejtimin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), puna në terren u realizua në datat 28 tetor-12 nëntor 2023 dhe në të u përfshinë të 61 bashkitë e Shqipërisë. Raporti fillon me një përmbledhje të metodologjisë së përdorur dhe profilin socio-demografik të kampionit. Më pas ai paraqet gjetjet e sondazhit në shtatë kategori: besimi në institucione; transparencë dhe llogaridhënia; korrupsioni në institucionet publike; ndikimi i interesave politike; pjesëmarrja qytetare; kënaqësia me ofrimin e shërbimeve publike; dhe përfshirja gjinore dhe sociale.

Ky është edicioni i katërt i financuar në kuadër të projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri” (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, që zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribuues kryesor, bashkë me UNDP-në.

1 Institucionet demokratike, reforma e administratës publike, sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria janë ‘bazat’ e acquis communautaire të BE-së nga Komisioni Evropian.

2. METODOLOGJIA

2.1 METODOLOGJIA STATISTIKORE DHE PËRSHKRIMI STATISTIKOR I KAMPIONIT

Për Sondazhin e Opinionit Publik ‘Besimi në qeverisje 2023’ u përdor një kampion përfaqësues i popullatës shqiptare në të cilin të anketuarit u përzgjedhën nga të gjitha bashkitë e vendit dhe njësitë e tyre administrative. Përdorimi i një kampioni përfaqësues kombëtar të ponderuar na bën të mundur të përgjithësojmë dhe t’i aplikojmë gjetjet e sondazhit tek e gjithë popullata si një e tërë. Kështu, niveli i vlefshmërisë statistikore i kampionit përshkruhet si vijon: për popullsinë në moshë madhore prej 2,180,897 banorësh,² me madhësi kampioni prej 2,500 të anketuarish, për nivel besimi prej 95%, marzhi i gabimit është ± 1.96 ; për nivel besimi prej 99%, marzhi i gabimit është ± 2.58 .

Për të përcaktuar madhësinë e kampionit për secilin nga 12 qarqet e vendit, të dhëna për popullsinë u morën nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilën qark më 1 janar 2023 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT).³ Kampioni prej 2,500 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë nga 12 qarqet e vendit. Më pas, shpërndarja sipas qarqeve u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (të moshës 18 vjeç e lart) dhe për të përdorur kontrolle të kuotave sipas gjinisë. Meqenëse INSTAT nuk përcakton grupmoshat nën 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, u përdor një teknikë lineare interpolimi.

Koeficienti i përfaqësimit të popullsisë për meshkujt shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç që nga 1 janari 2023 u përcaktua në 0.7841201 dhe për femrat mbi 18 vjeç në 0.7951076. Koeficienti i përgjithshëm i përfaqësimit të popullsisë për shqiptarët mbi 18 vjeç ishte 0.7896694.⁴ Si për ilustrim, në Tabelën 1 jepen shpërndarja sipas qarkut të popullatës rezidente shqiptare të moshës mbi 18 vjeç dhe madhësia e kampionit për secilin qark.

Tabela 1: Popullsia rezidente më 1 janar 2023 dhe madhësia e kampionit për secilin qark

Qarku	Popullsia rezidente 2023	Popullsia e moshës mbi 18 vjeç, 2023	Madhësia e kampionit për çdo qark		
			Burra	Gra	Gjithsej
Berat	111,431	87,994	50	51	101
Dibër	106,380	84,005	50	46	96
Durrës	289,797	228,844	132	130	262
Elbasan	252,719	199,564	112	116	228
Fier	271,672	214,531	123	123	246
Gjirokastrë	53,314	42,100	23	25	48
Korçë	192,925	152,347	86	89	175
Kukës	71,498	56,460	33	31	64
Lezhë	114,181	90,165	51	53	104
Shkodër	189,164	149,377	83	88	171

2 Shih Tabelën 1 për më shumë hollësi.

3 INSTAT e përkufizon popullsinë rezidente shqiptare si “të gjithë njerëzit që banojnë ose synojnë të qëndrojnë në Shqipëri për të paktën 12 muaj, pavarësisht kombësisë së tyre”. Për qëllim të këtij studimi, janë përfshirë shtetasit joshqiptarë.

4 Kjo do të thotë se 78.9% e popullsisë shqiptare janë mbi 18 vjeç që nga 1 janari 2023.

Qarku	Popullsia rezidente 2023	Popullsia e moshës mbi 18 vjeç, 2023	Madhësia e kampionit për çdo qark		
Tiranë	925,268	730,656	412	427	839
Vlorë	183,436	144,854	83	83	166
Total	2,761,785	2,180,897	1,238	1,262	2,500

2.2 INSTRUMENTI I SONDAZHIT

Ky raport mbështetet në të dhënat parësore të mbledhura si çdo vit me anë të një pyetësi të përsëritur që bën të mundur analizimin e të dhënave krahasimin në vite. Që nga viti 2013 sondazhi 'Besimi në qeverisje' ka ruajtur të njëjtat pyetje bazë për sa i përket besimit në qeverisje, transparencës dhe llogaridhënies, korrupsionit, pjesëmarrjes qytetare, dhe përdorimi i TIK. Megjithatë, përmbajtja e sondazhit përditësohet çdo vit për të marrë parasysh zhvillimet e fundit në Shqipëri. Ndryshoret (variablat) e rinj futen vetëm nëse është e nevojshme dhe pa ndikuar në krahasueshmërinë e të dhënave.

Në vitin 2023, si rezultat i rishikimeve nga një panel ekspertësh dhe konsultimeve me partnerët për zhvillim dhe në qeveri, u bënë disa ndryshime. U shtuan tre pyetje të reja dhe u modifikuan opsionet e përgjigjeve. Në të njëjtën, u hoqën pesë pyetje dhe u përjashtuan disa opsione përgjigjesh për t'u kuptuar qartë dhe lehtësisht nga të anketuarit. Kështu, në Seksionin I – Besimi në institucionet, vlerësimi i besimit të publikut tek institucionet në fjalë një (P1) përfshin tashmë një kategori të re, 'Gjykatën Kushtetuese'. Nga ana tjetër, janë hequr kategoritë 'Administrata Bashkiake' dhe 'Këshilli Bashkiak'. Po ashtu, u hoqën dy pyetje në lidhje me zbatimin e reformës në drejtësi dhe u zëvendësuan nga një pohim të ri të krijuar për të vlerësuar ndikimin e reformave në drejtësi në zhvillimin e vendit. Së fundi, u hoq edhe pyetja për matjen e kënaqësisë me ndihmën e huaj.

Në Seksionin II – Transparenca dhe Llogaridhënia, u hoq një pyetje në lidhje me të drejtën për informim. Më tej, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) u shtua në pyetjen e tretë (P3), për të vlerësuar ndërgjegjësimin e të anketuarve për mekanizmat institucionalë që i kërkojnë llogari qeverisë. Po ashtu, u hoqën dy opsione, 'deputetë të veçantë' dhe 'Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi'.

Në Seksionin III – Korrupsioni në Institucionet Publike është futur një pyetje e re për të vlerësuar perceptimin e publikut për efektivitetin e institucioneve të renditura në listën e luftës kundër korrupsionit.

Në Seksionin IV "Pjesëmarrja Qytetare" u prezantua një pyetje e re për të kapur perceptimin e publikut për fushat kryesore prioritare të punës së qeverisë në pesë vitet e ardhshme. U hoq një pyetje për pjesëmarrjen e qytetarëve. Po ashtu, dy pyetjet për perceptimin e sigurisë në jetën e përditshme u vendosën në këtë seksion, ndërkohë që vitet e mëparshme këto pyetje ishin pjesë e Seksionit të Ofrimit të Shërbimeve. Seksioni "Përdorimi i TIK" u hoq dhe tri pyetjet në të të fokusuara në transparencën online të bashkisë u përfshinë në seksionin II.

Në Seksionin V "Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike" përfshihen gjashtë pyetje nga seksioni i TIK-ut i vitit të kaluar, që trajtojnë përdorimin e portalit e-Albania për marrjen e shërbimeve elektronike dhe thithjen e mendimit të publikut për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave.

Në Seksionin VII "Përfshirja gjinore dhe sociale" janë hequr dy pyetje: pyetja lidhur me perceptimin e publikut nëse gratë dhe burrat janë njëjloj të aftë për të mbajtur ndonjë poste publike dhe pyetja për ndikimin e rritjes së përfaqësimit të grave në këshillin bashkiak.

Së fundi, në Seksionin "Demografia", të ardhurat e rregullta mujore u përditësuan për t'u përafëruar me shkallën e re të pagës minimale që ka hyrë në fuqi më 1 prilli 2023. Po ashtu, pyetjet për grupet e pakicave kombëtare dhe preferencat politike u rafinuan për më shumë qartësi.

2.3 MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE


Për mbledhjen e të dhënave u përdorën intervistat ballë për ballë. Para fillimit të punës në terren, u testua pyetësi paraprakisht dhe u trajnuan intervistuesit.

Procesi i intervistave u realizua gjatë periudhës 28 tetor-12 nëntor 2023 në të 61 bashkitë e vendit dhe njësitë administrative të tyre. Për mbledhjen e të dhënave u angazhuan gjithsej 43 intervistues. Në fund të punës në terren u kryen verifikime për kontrollin e cilësisë së të dhënave të mbledhura para hedhjes së tyre në sistem për përpunim. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan duke përdorur programin statistikor SPSS për të prezantuar më pas gjetjet e statistikave përshkruese dhe relacionale.

3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

Nga një kampion përfaqësues kombëtar prej 2,500 të anketuarish (të moshës 18 vjeç e sipër), 49.3% ishin femra dhe 50.4% meshkuj dhe 0.2% zgjodhën përgjigjen 'Tjetër'.⁵ Gjeografikisht, shpërndarja e kampionit sipas vendbanimit ishte 74% urbane dhe 26% rurale.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor



Baza: N=2500


Figura 2. Përfaqësimi sipas vendbanimit



Baza: N=2500

Grupmoshat dominuese në sondazh ishin 26–35 dhe 36–45 vjeç, që përbënin përkatësisht 24.9% dhe 22.6% të kampionit. Ata të moshës nën 26 vjeç përbënin 12.8% të të anketuarve. Për më tepër, 39.8% e të anketuarve bien në grupmoshës 46-86 vjeç, siç ilustron në Figurën 3.

Figura 3. Përqindja e të anketuarve sipas grupmoshës




Baza: N= 2500

5 Për shkak të numrit të kufizuar të pjesëmarrësve që zgjodhën opsionin "Tjetër", ata u përjashtuan nga analizat e dallimeve që u kryen sipas gjinisë.

Për sa i përket nivelit më të lartë arsimor, grupi më i madh përfaqësohet nga ata të anketuar me arsim të mesëm (40.4%), të ndjekur me një diferencë të vogël nga të anketuarit që kanë diplomë universitare (ose pasuniversitare) 37.9%. Vetëm 1.2% e të anketuarve thanë se janë pa arsim. Përqindja e individëve me të paktën arsim fillorë (4 klasë) ishte 3.3% dhe e atyre me arsimin e detyruar (8/9 klasë) ishin 16.5%.

Figura 4. Niveli i arsimit të përfunduar



Baza: N=2500

Në lidhje me statusin e punësimit në kohën e intervistës, 56.5% thanë se ishin të punësuar në kohën kur u bë intervista me ta. Mes të anketuarve të punësuar, 67.6% punonin në sektorin privat, 16.6% në sektorin publik ndërsa 15.8% zgjodhën opsionin "Tjetër".⁶ Rreth 20.6% e të anketuarve raportuan se ishin të papunë, ndërsa 11.2% ishin në pension, 5.8% ishin studentë, ndërsa 4.4% deklaruan një status të ndryshëm punësimi, si me paaftësi fizike, të vetëpunësuar, mes të tjerash.

Tabela 2: Statusi i punësimit


Statusi i punësimit	N	%
I/E punësuar	1412	56.5%
Sektori publik	412	16.6%
Sektori privat	1676	67.6%
Tjetër	391	15.8%
Gjithsej	2479	100.0%
I/E papunë	516	20.6%
Student	145	5.8%
Pensionist	280	11.2%

6 Të dhënat cilësore të mbledhura përmes pyetjeve të hapura sugjerojnë se ato korrespondojnë me të anketuarit e vetëpunësuar.

Statusi i punësimit	N	%
Tjetër	109	4.4%
Refuzoj	38	1.5%
Gjithsej	2500	100%

Për sa i përket nivelit të të ardhurave mujore, 24.6% e të anketuarve deklaruan se nuk kishin të ardhura. Grupi më i madh (26.3%) raportonte të ardhura mujore neto deri në 40.000 lekë, ndjekur nga 20.1% me të ardhura nga 40.001–60.000 lekë dhe 12.7% me të ardhura mujore që variojnë nga 60.001–80.000 lekë. Vetëm 5.4% e kampionit raportuan të ardhura mbi 80,001 lekë, ndërsa 11% nuk pranuan të deklaroheshin të ardhurat e tyre.

Figura 5. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto)



Baza: N=2500

Të anketuarve të këtij sondazhi iu bënë pyetje nëse identifikohen si me aftësi të kufizuara, dhe 5.4% deklaruan se kishin një paaftësi (N=132). Ndër ta, 58.3% (77 nga 132) raportuan se përfitonin pension invaliditeti.

Të pyetur nëse i përkisnin ndonjë grupi pakice, vetëm 3.6% deklaruan se bënë pjesë në një grup të tillë. Mes tyre, 45% u identifikuan si romë, 8% si egjiptianë, 10% si grekë, 4% si maqedonas dhe 3% si malazezë, 2% si bullgarë dhe 1% si arumunë. Rreth 26% e atyre që e konsideronin veten se i përkisnin një grupi pakice ishin ose të një grupi që nuk ishte në listë ose refuzuan të zbulonin se në cilin grup bënë pjesë. Në Tabelën 3 më poshtë jepen më shumë hollësi.

Tabela 3: Përqindja e të anketuarve që i përkasin një pakice kombëtare

A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	N	%
Po	91	3.6%
Greke	9	0.4%
Maqedonase	4	0.2%
Arumune	1	0.0%
Rome	41	1.6%

A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	N	%
Egjiptiane	7	0.3%
Malazeze	3	0.1%
Boshnjake	0	0.0%
Serbe	0	0.0%
Bullgare	2	0.1%
Refuzim i specifikimit të pakicës kombëtare	24	1.0%
Jo	2288	92.9%
Refuzim i përgjigjes	83	4.9%
Gjithsej	2481	100%

REZULTATET E SONDAZHIT TË OPINIONIT



4. BESIMI NË INSTITUCIONE

Besimi në institucione përfaqëson një nga shtyllat kryesore të Sondazhit të Opinioneve Publike “Besimi në Qeverisje”. Besimi në institucione interpretohet si besimi i qytetarëve tek organizmat shtetërorë. Këtu përfshihen parlamenti, qeveria, policia, gjykatat, institucionet publike të pavarura. Duke marrë parasysh rolin e tyre në qeverisjen e vendit, në sondazh shqyrtohet besimi i publikut edhe tek organizatat jo-shtetërore si media, organizatat fetare dhe ato joqeveritare (OJQ).

Në këtë pjesë të sondazhi, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej katër pikësh nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim) se sa i besojnë 19 aktorëve kryesorë shtetërorë dhe institucioneve publike. Supozimi bazë këtu është se shkalla e besimit në institucione të caktuara që tregohet nga të anketuarit në këtë sondazh të opinionit publik buron nga kombinimi i faktorëve në nivel makro dhe mikro. Implikimi është se të anketuarit tregojnë shkallën e besimit të tyre si qytetarë bazuar në perceptimin e përgjithshëm dhe përvojat që kanë me institucionet e përmendura pa pasur nevojë të kenë njohuri dhe informacion për krijimin dhe/ose funksionimin e institucioneve përkatëse.

BESIMI NË INSTITUCIONE

Qytetarët shqiptarë prirën të shprehin një nivel më të lartë besimi tek institucionet ndërkombëtare në krahasim me ato shqiptare. Tre institucionet me rezultatet më të larta për shqiptarët janë NATO, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara, me 76.7%, 74.7% dhe 74.3% përkatësisht të cilat mendojnë se kanë besim ose kanë shumë besim.

Ky fenomen duket se është për shkak të perceptimit se institucionet ndërkombëtare janë më neutrale ose të paanshme dhe janë më pak të ndjeshme ndaj konsideratave të brendshme politike që mund të prekin institucionet kombëtare. Për më tepër, pëlqimi për institucionet ndërkombëtare qëndron në aftësinë e tyre për të tërhequr ekspertë dhe profesionistë nga vende të ndryshme, duke ofruar një gamë të gjerë aftësish dhe perspektivash. Ky specializim dhe ekspertiza e tyre kontribuojnë drejtpërdrejt në një besim më të madh të këto institucione.


Në lidhje me institucionet vendase, qytetarët kanë treguar nivele të ndryshme besimi. Institucionet fetare (67%), SPAK (Prokuroria Speciale Kundër Korrupsionit) (60.3%), organizatat e shoqërisë civile (55.7%), forcat e armatosura (55.7%), media (53.4%) dhe sistemi arsimor publik (52.6%) perceptohen si më të besueshmet, për të cilat më shumë se gjysma e të anketuarve shprehin besim ose shumë besim në këto institucione.

Këtë vit, në sondazh u përfshi edhe Gjykata Kushtetuese në listën e institucioneve për herë të parë, ku 40% e individëve shprehën besim ose shumë besim ndaj saj. Ndërsa u hoqën kategoritë, u përjashtuan kategoritë e ‘administratës bashkiake’ dhe ‘këshilli bashkiak’.

Si për krahasim, prokuroria, gjykatat, parlamenti dhe partitë politike kanë besimin më të ulët të institucioneve kombëtare, me vetëm 33.7%, 33.4%, 29.1% dhe 25.5% të qytetarëve që shprehën se kanë besim ose shumë besim në këto institucione.

Besimi në qeverinë qendrore dhe atë vendore ishte pak a shumë i njëjtë, ku 42.8% dhe 43.6% e qytetarëve kanë shprehur besim ose shumë besim në to.

Figura 6. Besimi në institucione (2023)



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet

KRAHASIMI SOCIAL-DEMOGRAFIK I BESIMIT NË INSTITUCIONE

Gjatë shqyrtimit të dallimeve mes grupmoshave të të anketuarve, rezultatet nxjerrin në pah se të anketuarit e moshës 18-25 vjeç kanë një nivel relativisht më të ulët besimi tek të gjitha institucionet krahasuar me grupmoshat e tjera.

Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se nuk ka dallime të mëdha në përgjigjet ndërmjet grave dhe burrave për të gjitha institucionet. Të anketuarat femra dhe ata meshkuj kishin nivele të krahasueshme besimi në secilin prej institucioneve dhe aktorëve kryesorë të përshkruar në sondazh.

Individët me arsim universitar ose pasuniversitar kishin më shumë besim tek të gjitha institucionet në krahasim me ata me nivele më të ulëta arsimore.

Të anketuarit e punësuar në institucione publike ishin dukshëm më të prirur për të shprehur një nivel të lartë besimi tek të gjitha institucionet në krahasim me të anketuarit e tjerë të punësuar në sektorin privat. Ky trend ishte veçanërisht i theksuar kur bëhej fjalë për qeverinë qendrore, qeverisjen vendore, presidentin, parlamentin, gjykatën kushtetuese, SPAK, gjykatat, prokurorinë, policinë, forcat e armatosura dhe partitë politike.

Në Tabelën 5, në fund të këtij kapitulli, jepen informacione të hollësishme për nivelin e besimit mes ndryshoreve të ndryshme demografike.

BESIMI NË INSTITUCIONE NË VITE

Kur analizojmë vetëm institucionet vendase, institucionet fetare dalin si më të besuarat. Krahasuar me një vit më parë, ka pasur një rritje të lehtë, nga 71% në 74% të të anketuarve që kanë thënë se kanë besim tek këto institucione. SPAK, i cili renditet si institucioni i dytë më i besuar ndër institucionet kombëtare, ka pasur një rritje të dukshme prej 10 pikë përqindjeje krahasuar me vitin e kaluar.

Tabela 4 tregon nivelin e besimit (ose “Kam shumë besim” ose “Kam besim”) për 17 institucione gjatë viteve 2015-2023.

Institucionet ndërkombëtare kanë pasur përherë nivele më të larta besimi në krahasim me institucionet kombëtare. Partitë politike, gjykatat, prokuroria dhe parlamenti renditen vazhdimisht si institucionet më pak të besuara gjatë gjithë periudhës.

Më konkretisht, krahasuar me vitin 2022, besimi te presidenti ra me 6 pikë përqindje, ndërkohë që edhe parlamenti bashkë me partitë politike ranë me 5 pikë përqindjeje.

Tabela 4. Besimi në institucione në vite (2015–2023)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Mes.
NATO	74%	79%	84%	81%	78%	76%	73%	74%	77%	77%
OKB		80%	85%	79%	75%	76%	71%	71%	74%	76%
BE	72%	80%	85%	80%	73%	75%	71%	71%	75%	76%
Institucionet fetare	52%	58%	76%	73%	66%	70%	67%	64%	67%	66%
Forcat e armatosura	46%	55%	63%	63%	59%	54%	55%	60%	56%	57%
SPAK								50%	60%	55%
Sistemi arsimor	33%	59%	63%	64%	57%	54%	57%	55%	53%	55%
Shoqëria civile	38%	46%	57%	57%	56%	53%	53%	54%	56%	52%
Policia	46%	61%	53%	58%	55%	43%	46%	49%	49%	51%
Media	39%	58%	54%	56%	51%	45%	48%	45%	53%	50%
Institucionet e shëndetit publik	27%	50%	53%	54%	51%	45%	47%	47%	48%	47%
Qeveria vendore		49%	49%	47%	42%	42%	44%	41%	44%	45%
Qeveria qendrore	34%	44%	47%	42%	41%	36%	45%	43%	43%	42%
Presidenti	29%	36%	33%	30%	28%	24%	24%	41%	35%	31%
Parlamenti	22%	27%	34%	30%	28%	24%	33%	34%	29%	29%
Gjykata			21%	28%	27%	24%	28%	36%	33%	28%
Prokuroria			22%	28%	27%	24%	28%	33%	34%	28%
Partitë politike	15%	23%	21%	22%	23%	20%	26%	30%	25%	23%

Baza: N= 2500 in 2023, N= 2500 in 2022, N= 2500 in 2021; N=2488 -2499 in 2020; N=2499 in 2019; N=1647 in 2018, 2017, 2016.

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

* Nga viti 2017 e më tej, ‘Gjyqësori’ është ndarë në ‘Prokurori’ dhe ‘Gjykata’.

LEGJENDA: Ngjyrat nga e kuqja e errët deri në të verdhë dhe jeshile e hapur deri në jeshile të errët evidentojnë shifrat nën dhe mbi 50%.

DREJTËSIA E REFORMUAR


Shqiptarët kanë pikëpamje të polarizuara nëse sistemi i reformuar i drejtësisë po kontribuon pozitivisht në zhvillimin e vendit. 50.2%, janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim, ndërsa 44.9% në përgjithësi janë dakord ose nuk janë aspak dakord me të.

E ndërmarrë në vitin 2016, reforma në drejtësi në Shqipëri synon të luftojë korrupsionin e përhapur dhe ndikimin politik në procesin gjyqësor. Është një nga përpjekjet më të mëdha dhe më komplekse të reformës institucionale që po ndërmerret në vend, që konsiston ndër të tjera në vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, si pjesë e këtij programi të gjithanshëm reformash janë krijuar institucione të reja si Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Këtë vit, vlerësimi i perceptimit për ndikimin e sistemit të reformuar të drejtësisë tek zhvillimi i vendit u bë duke përdorur një qasje të ndryshme nga sondazhet e mëparshme. Më konkretisht, dy pyetjet e bëra në sondazhin e mëparshëm në lidhje me zbatimin e reformave në drejtësi u zëvendësuan me një pohim të ri që fokusohet te ndikimi i sistemit të reformuar të drejtësisë në zhvillimin e vendit. Ky rregullim në pyetësor do të bëjë të mundur të kuptohet më mirë opinioni i publikut për këtë temë.

Shqiptarët kanë opinione mjaft të polarizuara lidhur me masën në të cilën sistemi i reformuar i drejtësisë kontribuon pozitivisht në zhvillimin e vendit. Gjysma e të anketuarve, 50.2%, janë dakord ose plotësisht dakord se do të ketë një ndikim pozitiv. Nga ana tjetër, rreth 44.9% e qytetarëve përgjithësisht nuk ishin dakord ose aspak dakord me këtë perspektivë.

Figura 7. Perceptimi për ndikimin pozitiv të sistemit të reformuar të drejtësisë në zhvillimin e vendit (2023)



Baza: N=2500

Nuk pati dallime të mëdha sipas gjinisë, ku 48.9% e grave dhe 51.7% e burrave janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin se sistemi i reformuar i drejtësisë në Shqipëri po kontribuon pozitivisht në zhvillimin e vendit. Një prirje e qartë ishte se të anketuarit me nivel të lartë arsimor janë më të prirur të bien dakord me këtë pohim.

Të anketuarit që punojnë në sektorin publik janë më të afërt me besimin se drejtësia e reformuar është pozitive për zhvillimin në Shqipëri, ku 62.4% thonë se janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim. Por të anketuarit e sektorit privat i dhanë shumë më pak pikë, duke qëndruar në nivelin e 47.5%.


Për më shumë hollësi, shih Tabelën 6 në fund të këtij kreu.

PËRDORIMI I MEDIAVE

Televizioni vazhdon të mbetet ende burimi më popullor mediatik për shqiptarët, ku 49.8% thonë se TV është burimi i tyre kryesor i informacionit për aktualitetin. Mediat sociale përdoren nga 28.7% e të anketuarve, ndërsa portalet online janë burimi i preferuar për 14.7%.

Preferencat e qytetarëve për marrjen e informacionit ishin në përputhje me gjetjet e vitit të kaluar. Televizioni vazhdon të jetë burimi kryesor i informacionit për shqiptarët, me 49.8% që tregojnë se e përdorin më së shumti nga çdo media për të qenë të informuar për aktualitetin. Mediat sociale përdoren kryesisht nga 28.7%, ndërsa portalet online janë zgjedhur nga 14.7% e të anketuarve. Radio dhe shtypi janë dukshëm më pak të njohura, me vetëm 1.6% dhe 4.3% të qytetarëve, përkatësisht, që i përdorin ato si burimin kryesor të informacionit.

Figura 8. Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin në 2023



Baza: N=2499

Rezultatet e ndara sipas gjinisë tregojnë se gratë janë më të prirura se burrat për të përdorur mediat sociale si burim kryesor informimi, me 30.2% krahasuar me 26.6%. Mes të anketuarve të rinj (ata të moshës 18-25 vjeç), rreth gjysma (49.5%) përdorin mediat sociale si burimin kryesor të informimit. Nga ana tjetër, të anketuarit e moshës 66 vjeç e lart shfaqën një preferencë për metoda më tradicionale të komunikimit, ku 75.5% preferojnë TV.


Të anketuarit e moshës 46 vjeç e lart, ata me arsim të mesëm të ulët, pensionistët, ata me të ardhura mujore deri në 40,000 lekë dhe të anketuarit që banonin në zonat rurale kishin më shumë gjasa se grupet e tjera të raportonin TV si burimin e tyre të preferuar të medias. Në Tabelën 7 në fund të kreut jepet informacion më i plotë për ndarjen e të anketuarve për përdorimit të mediave sipas kategorive të ndryshme demografike.

SAKTËSIA E MEDIAVE

Në total 40.8% e shqiptarëve besojnë se informacioni që jepet nga mediat në Shqipëri është i saktë dhe i vërtetë.

Kur analizojmë rezultatet bazuar në burimin mediatic më të preferuar, pak më shumë se katër në dhjetë të anketuar që favorizojnë TV dhe mediat sociale (42%) besojnë se informacioni i dhënë nga media shqiptare është i saktë. Si për krahasim, ata që përdorin kryesisht portalet online kishin më pak gjasa të besonin në saktësinë e informacionit, me një përqindje prej 33.5%.

Figura 9. Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatic 2023




Baza: N=2500

Të anketuarit e moshuar, ata me arsim të lartë, të punësuarit në sektorin publik dhe ata që banojnë në zonat rurale ishin grupet me më shumë gjasa për të besuar në saktësinë e informacionit të dhënë nga mediat shqiptare.

Në vitin 2023, ka pasur një rritje të vogël në përqindjen e të anketuarve që e konsiderojnë si të saktë informacionin e paraqitur nga mediat shqiptare, krahasuar me sondazhin e kryer në vitin 2022. Në Figurën 10 më poshtë jepen të dhënat krahasuese të regjistruara në vitet 2016-2023.

Figura 10. Saktësia e mediave (2016–2023)



Baza: 2016 (N=1639); 2017 (N=1646); 2018 (N=1643); 2019 (N=2496); 2020 (N=2491); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); 2023 (N=2500) Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 5. Ndarja demografike e besimit ('kam shumë besim' dhe 'kam besim')

GJITHSEJ (% e 'kam shumë besim' dhe 'kam besim')		Qeveria qendrore	Qeveria vendore	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat Kushtetuese	SPAK	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Partitë politike	Institucionet e shëndetit publik	Sistemi arsimor	Media	Institucionet fetare	Shoqëria civile	BE	OKB	NATO
		43%	44%	35%	29%	34%	40%	60%	33%	49%	56%	25%	48%	53%	53%	67%	56%	75%	74%	77%
Gjinia																				
Gra		43%	45%	36%	29%	34%	38%	60%	33%	50%	58%	24%	49%	54%	55%	67%	56%	75%	74%	77%
Burra		42%	42%	34%	29%	33%	42%	61%	34%	47%	53%	27%	47%	52%	52%	67%	56%	74%	74%	76%
Mosha																				
18–25 vjeç		34%	36%	29%	23%	28%	36%	49%	29%	42%	50%	24%	35%	40%	48%	56%	52%	70%	68%	70%
26–35 vjeç		44%	44%	35%	29%	34%	39%	60%	33%	51%	57%	26%	49%	55%	53%	67%	57%	76%	75%	78%
36–45 vjeç		44%	45%	36%	33%	37%	41%	62%	38%	49%	56%	27%	50%	56%	54%	69%	56%	75%	76%	76%
46–55 vjeç		45%	46%	38%	31%	35%	41%	65%	35%	52%	57%	28%	50%	56%	55%	68%	58%	76%	76%	78%
56–65 vjeç		44%	42%	33%	29%	35%	43%	61%	32%	47%	51%	24%	49%	50%	53%	70%	54%	74%	75%	78%
66 vjeç e sipër		45%	46%	38%	28%	29%	38%	63%	28%	49%	61%	19%	52%	55%	58%	71%	53%	77%	74%	78%
Niveli arsimor																				
Me arsim deri 8/9-vjeçar		40%	42%	30%	26%	31%	33%	55%	29%	47%	51%	21%	48%	52%	51%	65%	54%	70%	69%	72%
Me arsim të mesëm		41%	40%	35%	28%	33%	41%	60%	33%	47%	55%	26%	46%	51%	53%	70%	57%	77%	77%	78%
Me arsim universitar		46%	48%	38%	32%	36%	42%	63%	36%	52%	59%	28%	49%	55%	56%	65%	56%	76%	75%	78%
Statusi i punësimit																				
I/E punësuar	Gjithsej	45%	47%	37%	33%	36%	43%	64%	36%	52%	59%	28%	51%	56%	53%	67%	57%	77%	77%	79%

4. BESIMI NË INSTITUCIONE

GJITHSEJ (% e 'kam besim' dhe 'kam shumë besim')	Qeveria gjendore	Qeveria vendore	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat Kushtetuese	SPAK	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Partitë politike	Institucionet e shëndetit publik	Sistemi arsimor	Media	Institucionet fetare	Shoqëria civile	BE	OKB	NATO
Sektori publik	57%	57%	46%	43%	44%	50%	71%	44%	58%	67%	34%	55%	63%	60%	70%	64%	79%	80%	81%
Sektori privat	40%	41%	33%	26%	33%	38%	59%	32%	47%	53%	23%	47%	51%	52%	66%	54%	74%	73%	76%
I/E papunë	39%	39%	32%	24%	32%	35%	55%	32%	43%	49%	21%	41%	47%	56%	71%	55%	73%	73%	75%
Student	35%	37%	28%	21%	25%	33%	47%	24%	46%	55%	24%	38%	41%	52%	59%	52%	70%	68%	70%
Pensionist	42%	43%	33%	26%	33%	37%	57%	31%	45%	54%	24%	49%	51%	53%	65%	57%	73%	70%	74%
Vendbanimi																			
Urban	42%	43%	35%	29%	34%	39%	59%	33%	49%	56%	26%	47%	51%	53%	66%	56%	74%	73%	75%
Rural	44%	45%	35%	31%	33%	43%	64%	33%	48%	55%	24%	51%	57%	55%	70%	54%	76%	77%	80%
Niveli i të ardhurave																			
Pa të ardhura	37%	38%	31%	23%	30%	33%	53%	31%	43%	51%	22%	42%	46%	56%	68%	55%	73%	72%	74%
Deri në 40,000 lekë	43%	42%	33%	30%	33%	39%	61%	32%	49%	54%	26%	52%	53%	53%	66%	57%	73%	74%	75%
40,001–60,000 lekë	46%	48%	40%	34%	39%	46%	64%	37%	50%	62%	28%	51%	58%	52%	68%	60%	81%	79%	82%
60,001–80,000 lekë	45%	48%	39%	34%	37%	44%	65%	38%	53%	57%	31%	48%	54%	55%	68%	59%	75%	76%	78%
Mbi 80,001 lekë	45%	46%	33%	35%	29%	34%	62%	27%	51%	57%	27%	47%	51%	56%	65%	51%	76%	74%	77%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar)..

Tabela 6. Perceptimi për ndikimin e sistemit të reformuar të drejtësisë në zhvillimin e vendit (2023)

		Sistemi i reformuar i drejtësisë në Shqipëri po kontribuon pozitivisht në zhvillimin e vendit.
Gjithsej		50%
Gjinia		
Gra		49%
Burra		52%
Mosha		
18–25 vjeç		39%
26–35 vjeç		52%
36–45 vjeç		54%
46–55 vjeç		53%
56–65 vjeç		48%
66 vjeç e sipër		50%
Niveli arsimor		
Me arsim deri 8/9-vjeçar		45%
Me arsim të mesëm		50%
Me arsim universitar		53%
Statusi i punësimit		
Gjithsej		53%
I/E punësuar	Spektori publik	62%
	Spektori privat	47%
I/E papunë		46%
Student		39%
Pensionist		47%
Niveli i të ardhurave		
Pa të ardhura		45%
Deri në 40,000 lekë		48%
40,001–60,000 lekë		53%
60,001–80,000 lekë		57%
Mbi 80,001 lekë		54%
Vendbanimi		
Urban		49%
Rural		54%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve




Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 7. Ndarja demografike e përdorimit të mediave (2023)

	Burimi mediatik më i përdorur				
	Gazeta (e printuar/elektronike)	Portalet	Media sociale	Portals	Social media
Gjithsej	50%	2%	4%	15%	28%
Gjinia					
Gra	49%	1%	4%	14%	30%
Burra	50%	2%	4%	15%	27%
Mosha					
18–25 vjeç	24%	1%	3%	20%	50%
26–35 vjeç	35%	2%	5%	20%	36%
36–45 vjeç	47%	2%	4%	16%	31%
46–55 vjeç	61%	1%	3%	13%	21%
56–65 vjeç	74%	1%	4%	8%	12%
66 vjeç e sipër	75%	2%	8%	3%	12%
Niveli arsimor					
Me arsim deri 8/9-vjeçar	62%	1%	4%	11%	22%
Me arsim të mesëm	51%	2%	4%	16%	26%
Me arsim universitar	42%	2%	5%	16%	34%
Statusi i punësimit					
Gjithsej	47%	2%	4%	15%	29%
I/E punësuar					
Sektori publik	44%	2%	5%	16%	31%
Sektori privat	51%	1%	4%	15%	28%
I/E papunë	54%	1%	4%	14%	27%
Student	26%	2%	4%	21%	46%
Pensionist	65%	1%	4%	10%	20%
Niveli i të ardhurave					
Pa të ardhura	49%	1%	5%	15%	30%
Deri në 40,000 lekë	53%	2%	5%	12%	27%
40,001–60,000 lekë	43%	2%	4%	16%	34%
60,001–80,000 lekë	49%	2%	4%	17%	27%
Mbi 80,001 lekë	49%		2%	15%	29%
Vendbanimi					
Urban	48%	2%	4%	16%	29%
Rural	56%	2%	5%	10%	27%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve.

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).



5. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementët më të rëndësishëm për funksionimin e duhur të sistemit të demokracisë. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe u bëjnë të mundur qytetarëve të ndikojnë në procesin vendimmarrës dhe t'u kërkojnë llogari pushtetarëve. Kombet e Bashkuara njohin rëndësinë e ndërtimit të institucioneve të përgjegjshme dhe transparente si pjesë e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Objektivi 16 synon promovimin e shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e aksesit në drejtësinë për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, kurse Objektivi 16.6. fokusohet te zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Transparencë do të thotë që qeveria vepron në mënyrë të hapur duke dhënë informacione të sakta për veprimtarinë dhe shpenzimet e saj, për operacionet e saj dhe për vendimet që merr. Element kyç i transparencës është e drejta për akses tek informacioni që është në pronësi të autoriteteve publike, shoqëruar me bërjen të mundur që institucionet publike vendimmarrëse të jenë të hapura për publikun.


Nga ana tjetër, **llogaridhënia** kërkon që qeveria të marrë përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e saj. Ajo ka dy dimensione: përgjegjësia për t'u përgjigjur – ose detyrimi i autoriteteve publike për t'i dhënë publikut informacione dhe shpjegime për veprimtaritë e tyre; dhe zbatimimi ose mekanizmat, me anë të të cilave informacioni që merret mund të sigurojë që qeveria merr masa për çdo dështim. Llogaridhënia mund të jetë vertikale (drejtpërdrejtë me publikun) ose horizontale (që mundësohet nëpërmjet mekanizmave të kontrollit që veprojnë ndërmjet institucioneve publike).

TRANSPARENCA

Të dhënat për vitin 2023 nxjerrin në pah mungesën e besimit të transparencës së qeverisë qendrore dhe asaj vendore.

Pjesa më e madhe e të anketuarve, që përbën 59%, u shprehën se nuk ishin dakord ose aspak dakord me pohimin se qeveria qendrore funksionon në mënyrë transparente.

Figura 11. Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe asaj vendore (2023)



Baza: Qeveria qendrore (N=2500); bashkia (N=2500)

E njëjta ndjesi u vu re kur të anketuarit u pyetën për perceptimin e tyre për qeverisjen e tyre vendore. Rreth 60% ose nuk ishin dakord ose aspak dakord me pohimin se bashkia është transparente.

Gratë dhe burrat kishin perceptime të ngjashme për sa i përket transparencës si të qeverisë qendrore ashtu edhe të bashkive të tyre. Për sa i përket moshës, ndonëse nuk kishte dallime thelbësore, vlen të përmendet se të anketuarit më të rinj në moshë (18-25 vjeç) dhanë një rezultat relativisht më të ulët për transparencën. Në këtë grupmoshë, 27% mendonin se qeveria qendrore ishte transparente dhe 29% mendonin se bashkia ishte transparente.


Të anketuarit me diplomë universitare kishin perceptimin më të lartë për transparencën si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Të anketuarit e punësuar, qoftë në sektorin publik apo privat, kishin një perceptim më të lartë për transparencën krahasuar me të anketuarit e papunë dhe studentët. Përveç kësaj, punonjësit e sektorit publik kishin më shumë gjasa të mendonin se qeveria qendrore është transparente në krahasim me të anketuarit e punësuar në sektorin privat (55% kundrejt 35%).

Ndonëse kishte pak më shumë besim në transparencën e qeverisë qendrore dhe bashkive nga të anketuarit nga zonat rurale në krahasim me të anketuarit urbanë, ky dallim nuk u konsiderua i madh.

LLOGARIDHËNIA

Shumica dërrmuese e shqiptarëve shprehin mendimin se si pushtetit qendror ashtu edhe atij vendor i mungon llogaridhënia. Vetëm 33.6% e të anketuarve deklarojnë se e konsiderojnë qeverinë qendrore të përgjegjshme dhe një përqindje pak më e lartë, 36.4%, thonë se bashkia e tyre është e përgjegjshme (jep llogari).

Figura 12. Perceptimi për llogaridhënien e qeverisë qendrore dhe vendore (2023)



Baza: Qeveria qendrore (N=2500); bashkia (N=2500)

Gjatë analizimit të të dhënave sipas gjinisë, nuk kishte dallime të mëdha në perceptimet e grave dhe burrave për llogaridhënien e secilit nivel të qeverisjes. Rreth 34% e grave besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 37% mendonin të njëjtën gjë për bashkinë e tyre. Këto shifra për meshkujt janë përkatësisht 33% dhe 36%.

Të anketuarit e moshës 66 vjeç e lart kishin perceptimin më të mirë për llogaridhënien në krahasim me të gjitha grupmoshat, ku 37% e tyre besonin se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 40% besojnë të njëjtën gjë për bashkinë e tyre. Të anketuarit me diplomë universitare kishin perceptimin më të lartë për llogaridhënien sipas nivelit arsimor, ku kemi 37% që kanë këtë mendim për pushtetin qendror dhe 41% për bashkinë.


Të anketuarit në marrëdhënie pune kishin më shumë gjasa ta shihnin qeverinë si të përgjegjshme në krahasim me të anketuarit e papunë, me 35% që besonin se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 39% besonin se bashkia e tyre është e përgjegjshme. Të dhënat sugjerojnë një ndryshim të dukshëm mes punonjësve të sektorit publik dhe atij privat, ku shumica e punonjësve të sektorit publik kanë një perceptim pozitiv të llogaridhënies për të dy nivelet (47% për qeverinë qendrore dhe 51% për bashkinë). Si për kontrast, vetëm 31% e punonjësve të sektorit privat mendonin se qeveria qendrore ishte jep llogari dhe 33% besonin të njëjtën gjë për bashkinë e tyre.

Të anketuarit që jetojnë në zonat rurale treguan besim më të madh në llogaridhënien e qeverisë në krahasim me të anketuarit e zonave urbane, me 35% që besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 35% që besojnë se bashkia e tyre jep llogari. Për një ndarje më të plotë demografike lutemi referojuni Tabelës 8.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE NË VITE

Duhet theksuar se qeveria vendore mori vazhdimisht vlerësime pak më të larta për llogaridhënien në krahasim me qeverinë qendrore, ndonëse vlerësimet për transparencën e të dy niveleve mbetën afërsisht të njëjta në vitin 2023.

Figura 13. Ndryshimi në perceptimin për transparencën e institucioneve 2016–2023




Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1646); 2017 (N=1635); 2018 (N=1644); 2019 (N=2491); 2020 (N=2495); 2021 (N=2500); 2023 (N=2500); dhe bashkia: 2016 (N=1645); 2017 (N=1633); 2018 (N=1643); 2019 (N=2485); 2020 (N=2489); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); 2023 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

Në vitin 2023, bashkitë pësuan një rënie prej 4 pikë përqindjeje nga zhvendosja pozitive fillestare që u vu re në vitet 2019-2021, duke e rikthyer perceptimin e publikut në nivelin e 36%. Ndërkohë, qeveria qendrore, pas rritjes me 8 pikë përqindjeje të transparencës nga viti 2019 në vitin 2021, u përball me një ulje të mëvonshme prej 3 pikë përqindjeje për t'u vendosur në nivelin 38% në vitin 2023.

Për sa i përket llogaridhënies në vitin 2023, vlerësimet për qeverinë qendrore ranë me 2 pikë përqindjeje nga viti 2021, duke arritur në 34%, duke pasuar një rritje nga 31% në 2019 në 38% në 2021. Po kështu, në vitin 2023, edhe bashkitë pësuan një rënie prej 3 pikë përqindjeje në llogaridhënie, duke pësuar një rënie të vlerësimit të përmirësuar të tyre nga 39% në 2021 në 36% në 2023.

Figura 14. Ndryshimi në perceptimin për llogaridhënien e institucioneve 2016–2023


Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1646); 2017 (N=1635); 2018 (N=1644); 2019 (N=2491); 2020 (N=2495); 2021 (N=2500), 2022 (N=2500); 2023 (N=2500) dhe bashkia: 2016 (N=1645); 2017 (N=1633); 2018 (N=1643); 2019 (N=2485); 2020 (N=2489); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); 2023 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

DIJENIA PËR FAQEN E INTERNETIT TË BASHKISË DHE PËRDORIMI I SAJ


Figurat tregojnë se 23.2% e të anketuarve janë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti..

Një numër i vogël të anketuarish (4.4%) thanë se bashkia e tyre nuk ka faqe interneti. Duhet theksuar se 35% e pjesëmarrësve në këtë sondazh nuk kishin dijeni nëse bashkia e tyre kishte faqe interneti apo jo.

Figura 15. Përqindja e të anketuarve që janë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti (2023)

Baza: N=2500

38.1% e të anketuarve që ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte faqe interneti thanë se e përdorin atë. Kjo sugjeron se pjesa tjetër, një shumicë prej 61.9%, e atyre që kanë dijeni për ekzistencën e faqes së internetit nuk e përdorin këtë të fundit.

Figura 16. Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2023)

Baza: N=1524

Si gratë ashtu edhe burrat shfaqën nivele të ngjashme të dijenisë dhe kishin të njëjtin nivel përdorimi të faqeve të internetit të bashkive. Rreth 24% e grave kishin dijeni për faqen e internetit të bashkisë së tyre dhe e përdornin atë rregullisht, ndërkohë që 37% janë në dijeni të ekzistencës së kësaj faqeje por që nuk e përdorin atë.


Të dhënat sipas grupmoshës tregojnë se të anketuarit më të rinj në moshë priren të jenë më të informuar për ekzistencën e faqeve të internetit të bashkive dhe t'i përdorin ato më shumë sesa grupmoshat në moshë më të madhe. Tendencë e ngjashme vihet re edhe kur shqyrtojmë të dhënat bazuar në nivelin arsimor. Rreth 69% e të anketuarve me diplomë universitare ishin në dijeni të ekzistencës së faqes së internetit të bashkisë, përqindje që bie në 48% tek ata me arsim deri në nivelin e detyrueshëm.

Një numër më i madh të anketuarish që punojnë në sektorin publik kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë krahasuar me ato që punojnë në sektorin privat, me shifrat që janë në nivelin e 32% dhe 21%, përkatësisht.

Ka pasur një hendek të theksuar në njohuritë për faqen e internetit të bashkisë mes atyre që jetojnë në zonat urbane dhe atyre nga zonat rurale, me përqindje që janë 64% dhe 52% përkatësisht..

FAQJA E INTERNETIT E BASHKISË NË VITE

Figura 17 ilustron të dhënat që mbulojnë vitet 2014-2023. Përqindja e të anketuarve që raportojnë se janë në dijeni të ekzistencës së faqes së internetit të bashkisë është pothuajse dyfishuar që nga viti 2014 edhe pse me luhatje në vite. Megjithatë, ka pasur një rënie të lehtë të përqindjes në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.


Figura 17. Përqindja e të anketuarve që janë në dijeni të faqes së internetit të bashkisë së tyre (2014-2023)

Baza: 2015 (N=1565); 2016 (N=1618); 2017 (N=1640); 2018 (N=1638); 2019 (N=2493), 2020 (N=2500), 2021 (N=2500), 2022 (N=2492), 2023 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

Pavarësisht rritjes së nivelit të njohurive në vite, kjo rritje nuk është shoqëruar me rritje në përdorimin e këtyre faqeve. Në fakt, krahasuar me vitin 2022, përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkive ka rënë me 8 pikë përqindje.

Figura 18. Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2016–2023)



Baza: 2016 (N=692); 2017 (N=638); 2018 (N=654); 2019 (N=1556); 2020 (N=1575); 2021 (N=1493); 2022 (N=1616); 2023 (N=1524)


Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar..

QËLLIMI I PËRDORIMIT TË FAQES SË INTERNETIT TË BASHKISË

Arsyeja kryesore që japin të anketuarit për vizitën në faqen e internetit të bashkisë është marrja e informacionit për llojet e shërbimeve që ofrohen dhe ku dhe si t'i marrin këto shërbime, duke përfaqësuar 43.6%.

Ata të anketuar që kanë thënë se përdorin faqen e internetit të bashkisë u pyetën më tej për qëllimin kryesor të përdorimit të saj. Arsyeja kryesore që qytetarët dhanë ishte marrja e informacioneve për llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si dhe ku mund t'i marrin ato, duke përfaqësuar 43.6% të kampionit. Arsyeja e dytë më e shpeshtë për përdorimin e faqes së internetit të bashkisë ishte marrja e informacionit për programet apo të reja për vendin ku jetojnë, me një përqindje prej 35%. Rreth 19% e qytetarëve që ishin në dijeni për faqen e internetit thanë se e kishin përdorur atë për t'u njohur me vendimet e këshillit bashkiak. Një tjetër 14.1% e përdorën faqen e internetit për t'u informuar për buxhetin e bashkisë dhe 13.1% e përdorën atë për të bërë ankesa apo komente te stafi i bashkisë.

Figura 19. Arsyt kryesore të përdorimit të faqes së internetit të bashkisë (me disa zgjedhje)



Baza: N=737

LLOGARIDHËNIA HORIZONTALE DHE VERTIKALE


Në vitin 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit ishte institucioni vendas i përmendur nga shumica e pjesëmarrësve se luan më shumë rol për t'i kërkuar llogari qeverisë, duke zënë një përqindje të konsiderueshme prej 58.6%. Parlamenti vjen më pas me 49.5%. Për sa i përket mekanizmave vendas të llogaridhënies vertikale, media vlerësohet se luan rolin më të rëndësishëm, me 54.2% të të anketuarve që e shprehin këtë. Perceptimi vazhdon se organizatat ndërkombëtare janë organizmat më efektivë për kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë, me 69.4% që e njohin rolin e tyre në këtë drejtim.

Llogaridhënia horizontale ushtrohet me anë të një rrjeti institucionesh dhe ka të bëjë me kapacitet e institucioneve shtetërore, të tillë si parlamenti dhe gjyqësori, për të mbikëqyrur politikat e qeverisë duke i kërkuar asaj informacione, duke kontrolluar zyrtarët dhe duke ndëshkuar shkeljet apo sjelljet e gabuara.

Institucioni vendas i perceptuar më së shumti se i kërkon llogari qeverisë për vitin 2023 ishte Kontrolli i Lartë i Shtetit, me 58,6% të të anketuarve, ndjekur nga parlamenti me 49,5% dhe Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) me një vlerësim prej 48.4%.

Nga ana tjetër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave dhe partitë politike opozitare u konsideruan si më pak efektive për rolin në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë, me vlerësime përkatëse prej 43.4% dhe 38.9%.

Figura 20. Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale (2023)



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet e listuara

Duhet thënë se rreth gjysma e të anketuarve besonin se institucionet kombëtare janë efikase në kërkesën e tyre të llogarisë ndaj qeverisë.

Në të gjitha kategoritë demografike, Kontrolli i Lartë i Shtetit u perceptua si subjekti më efikas në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Të dhënat sipas ndarjes gjinore nuk nxorën në pah ndonjë dallim të madh në lidhje me efektivitetin e institucioneve vendase.

Megjithatë, një tendencë që vihej re ishte se, me rritjen e nivelit të arsimit, pati një rritje përkatëse në perceptimin e aftësive të institucioneve për t'i kërkuar llogari qeverisë.


Punonjësit në sektorin publik ishin më të prirur të besonin se të gjitha institucionet e listuara, si parlamenti (58%), KLSH (68%), partitë e opozitës (42%), Avokati i Popullit (50%), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (57%) dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktet e Interesit (ILDKPKI) (57%) luajnë rol efektive në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë përgjegjëse në krahasim me ata që punojnë në sektorin privat.

Llogaridhënia vertikale i referohet marrëdhënieve mes institucioneve dhe qytetarëve, ku përfshihet roli i qytetarëve, medias, dhe shoqërisë civile që u kërkojnë llogari zyrtarëve të pushtetit për punën e tyre. Qytetarët në bashkëpunim me median dhe shoqërinë civile luajnë një rol të rëndësishëm për zbatimin e llogaridhënies vertikale.

Të dhënat e raportit të vitit 2023 nxjerrin në pah një perceptim të vazhdueshëm se organizatat ndërkombëtare kanë më shumë gjasa t'i kërkojnë llogari qeverisë, me 69.4% të të anketuarve që kanë këtë mendim.

Ndër mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies vertikale, media u identifikua si më efektive, me 54.2% të të anketuarve që shprehin këtë pikëpamje, ndjekur nga organizatat e shoqërisë civile me 44.9%, sindikatat me 41.7% dhe bizneset/shoqatat e biznesit me 41.1%.

Figura 21. Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale (2023)



Baza: N=2500

Perceptimi i mediave dhe organizatave ndërkombëtare si organizmat më efektivë të llogaridhënies ishte në përputhje sipas kategorive të ndryshme demografike. Gratë shfaqën pak më shumë besim tek organizatat ndërkombëtare (71%) në krahasim me burrat (68%) edhe pse rezultatet ishin të barabarta për institucionet e tjera më efektive, si mediat (54% për të dy gjinitë) dhe organizatat e shoqërisë civile (45% për të dy gjinitë).

Të dhënat tregojnë se të anketuarit me diplomë universitare kanë dhënë vlerësime më të larta për të gjitha institucionet krahasuar me të anketuarit me nivele të tjera arsimore.

Punonjësit e sektorit publik dhanë vlerësimet më të larta për llogaridhënien për të gjitha institucionet e listuara, veçanërisht për organizatat ndërkombëtare (72%) dhe mediat (55%). Në kahun e kundërt, punonjësit e sektorit privat në përgjithësi shprehën më pak besim në llogaridhënien e institucioneve në krahasim me të anketuarit nga sektori publik. Për ta, institucionet ndërkombëtare u perceptuan si organizmi më efektiv, me një vlerësim prej 69%.

Individët me nivele më të larta të ardhurash kanë pasur vazhdimisht një perceptim më të favorshëm për efektivitetin e të gjitha institucioneve të listuara.

Tabela 8: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien (2023)

	Qeveria qendrore është transparente	Bashkia është transparente	Qeveria qendrore është e përgjegjshme	Bashkia është e përgjegjshme
Gjithsej	38%	36%	34%	36%
Gjinia				
Gra	38%	37%	34%	37%
Burra	37%	36%	33%	36%
Mosha				
18–25 vjeç	27%	29%	18%	29%
26–35 vjeç	40%	38%	34%	39%
36–45 vjeç	41%	37%	34%	37%
46–55 vjeç	41%	37%	36%	37%
56–65 vjeç	37%	35%	33%	34%
66 vjeç e sipër	39%	42%	37%	40%
Niveli arsimor				
Me arsim deri 8/9-vjeçar	35%	33%	31%	34%
Me arsim të mesëm	35%	33%	32%	33%
Me arsim universitar	42%	41%	37%	41%
Statusi i punësimit				
Gjithsej	41%	39%	35%	39%
I/E punësuar	55%	51%	47%	51%
Sektori publik	55%	51%	47%	51%
Sektori privat	35%	33%	31%	33%
I/E papunë	33%	31%	31%	33%
Student	31%	32%	29%	30%
Pensionist	39%	39%	35%	36%
Niveli i të ardhurave				
Pa të ardhura	33%	32%	31%	32%
Deri në 40,000 lekë	38%	36%	34%	35%
40,001–60,000 lekë	42%	42%	37%	42%
60,001–80,000 lekë	42%	40%	37%	41%
Mbi 80,001 lekë	38%	35%	32%	35%
Vendbanimi				
Urban	37%	35%	33%	37%
Rural	42%	39%	35%	35%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve.

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).



Tabela 9: Ndarja social-demografike për llogaridhënien horizontale dhe vertikale 2023)

	Parlamenti	KLSH	Partitë e opozitës	Avokati i Popullit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI)	Organizatrat e shoqërisë civile	Media	Bizneset /shoqata biznesi	Sindikatat	Organizatrat	
Gjithsej (% për llogaridhënien)	50%	59%	39%	44%	43%	48%	45%	54%	41%	42%	70%	
Gjinia												
Gra	49%	58%	41%	44%	43%	48%	45%	54%	40%	40%	68%	
Burra	50%	60%	37%	45%	44%	49%	45%	54%	43%	43%	71%	
Mosha												
18–25 vjeç	43%	51%	38%	41%	42%	41%	45%	50%	37%	43%	66%	
26–35 vjeç	48%	58%	41%	45%	45%	52%	45%	55%	44%	44%	72%	
36–45 vjeç	52%	61%	39%	46%	45%	52%	44%	54%	44%	42%	72%	
46–55 vjeç	53%	63%	39%	44%	42%	47%	47%	57%	41%	39%	69%	
56–65 vjeç	51%	58%	39%	42%	41%	47%	43%	53%	38%	38%	67%	
66 vjeç e sipër	46%	58%	33%	44%	44%	46%	47%	54%	37%	42%	66%	
Niveli arsimor												
Me arsim deri 8/9-vjeçar	43%	55%	34%	42%	38%	43%	42%	47%	41%	39%	64%	
Me arsim të mesëm	51%	58%	39%	44%	43%	47%	43%	55%	39%	42%	70%	
Me arsim universitar	51%	61%	41%	46%	47%	52%	49%	57%	44%	43%	73%	
Statusi i punësimit												
I/E punësuar	Gjithsej	53%	61%	41%	46%	46%	51%	47%	55%	44%	44%	72%

	Parlamenti	KLSH	Partitë e opozitës	Avokati i Popullit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI)	Organizatrat e shoqërisë civile	Media	Bizneset /shoqata biznesi	Sindikatat	Organizatrat
Sektori publik	58%	68%	42%	50%	57%	57%	53%	61%	47%	46%	76%
Sektori privat	48%	57%	38%	43%	40%	46%	43%	53%	41%	42%	69%
I/E papunë	42%	53%	38%	44%	38%	41%	41%	56%	37%	39%	69%
Student	44%	51%	34%	37%	37%	39%	44%	46%	38%	38%	61%
Pensionist	48%	62%	37%	48%	46%	54%	46%	54%	36%	41%	64%
Niveli i të ardhurave											
Pa të ardhura	41%	53%	36%	40%	37%	39%	42%	53%	38%	40%	67%
Deri në 40,000 lekë	51%	58%	37%	47%	45%	51%	44%	54%	41%	41%	67%
40,001–60,000 lekë	54%	65%	41%	50%	54%	58%	46%	53%	45%	48%	75%
60,001–80,000 lekë	56%	67%	46%	48%	49%	52%	54%	58%	45%	46%	68%
Mbi 80,001 lekë	51%	57%	39%	36%	39%	42%	41%	58%	40%	35%	71%
Vendbanimi											
Urban	49%	60%	40%	45%	45%	48%	46%	55%	43%	43%	70%
Rural	52%	55%	37%	41%	39%	49%	41%	51%	36%	39%	69%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).



6. KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Korrupsioni, i përkufizuar si abuzimi me autoritetin publik për përfitime personale, mund të kategorizohet në dy lloje kryesore: korrupsion i vogël dhe korrupsion i madh.

Korrupsioni i vogël ka të bëjë me akte të vogla korrupsioni që ndodhin në jetën e përditshme, shpesh në nivelet më të ulëta të qeverisjes ose shërbimeve publike. Është abuzimi me autoritetin që i është besuar zyrtarëve publikë kur ata angazhohen ose ndërveprojnë me qytetarë që kërkojnë të mira apo shërbime bazë në fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe zbatimi i ligjit.

Korrupsioni i madh i referohet korrupsionit të nivelit të lartë që përfshin shuma të konsiderueshme parash, zakonisht fonde publike, dhe shpesh implikon zyrtarë ose institucione të nivelit të lartë. Është keqpërdorim i pushtetit të nivelit të lartë që u sjell fitime një grupi të vogël njerëzish në kurriz të shumicës dhe u shkakton dëm serioz dhe të gjithanshëm individëve dhe shoqërisë.

Të dy format e korrupsionit kanë pasoja të rënda dhe afatgjate, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme për njerëzit dhe shoqërinë në tërësi, duke cenuar integritetin, drejtësinë dhe efektivitetin e institucioneve.

Çdo vit pyetësi bën një sërë pyetjesh që synojnë mbledhjen e informacionit për çështje të ndryshme që lidhen me korrupsionin. Këto pyetje zakonisht kanë të bëjnë me:

- **Perceptimet për përhapjen e korrupsionit:** Vlerësohet perceptimi për përhapjen e korrupsionit të vogël dhe të madh në një kontekst të dhënë.
- **Besimi në ndjekjen penale të korrupsionit:** Shqyrtohet niveli i besimit që kanë të anketuarit për sa i përket ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit të vogël dhe të madh.
- **Përvoja personale me korrupsionin:** Përcaktohet nëse të anketuarit kanë pasur raste ku kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në institucionet publike.
- **Perceptimi për institucionet më të korruptuara:** Identifikohen institucionet që të anketuarit besojnë se janë më të korruptuarat.
- **Përhapja e ryshfetit:** Përcaktohet nëse të anketuarit që kanë marrë shërbime nga institucionet në nivel qendror apo vendor i kanë dhënë ryshfet një zyrtari publik, duke pasqyruar kështu përvojat personale me korrupsionin.

Këto pyetje synojnë të na japin opinione për përhapjen e korrupsionit, perceptimet publike për integritetin institucional dhe përvojën individuale me praktikën korruptive. Vazhdimësia me të njëjtat pyetje gjatë këtyre viteve na bën të mundur të shohim tendencat dhe ndryshimet në qëndrimet ndaj korrupsionit.

PERCEPTIMET PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT

Në sondazhin e vitit 2023, shumica e të anketuarve (81.3%) mendojnë se korrupsioni i vogël është 'i përhapur' ose 'shumë i përhapur', ndërkohë që vetëm 16.2% që e konsiderojnë atë 'jo të përhapur' ose 'aspak të përhapur'. Sa i përket korrupsionit të madh, 81.5% e të anketuarve e konsiderojnë atë si 'të përhapur' ose 'shumë të përhapur', ndërkohë që 15.6% e shohin atë 'jo të përhapur' ose 'aspak të përhapur'. Për vitin 2023, tre institucionet më të përmendura janë institucionet e drejtësisë (17.5%), institucionet e kujdesit shëndetësor (14.8%) dhe policia (7.2%).


Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin përhapjen e korrupsionit duke përdorur një shkallë me 4 pikë, duke filluar nga 1 (aspak i përhapur) në 4 (shumë i përhapur). U morën parasysh dallimet midis korrupsionit të vogël dhe korrupsionit të madh.

Për qëllime analize, janë bashkuar kategoritë 'aspak i përhapura' dhe 'nuk është i përhapur', si dhe kategoritë 'i përhapur' dhe 'shumë i përhapur'. Kjo thjeshton të dhënat duke krijuar dy grupe më të mëdha për analiza më të drejtpërdrejta dhe të përgjithësuara.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se tetë në dhjetë shqiptarë besojnë se korrupsioni i vogël dhe i madh është i përhapur ose shumë i përhapur në vend.

Në vitin 2023, shumica e të anketuarve (81.3%) thanë se korrupsioni i vogël ishte 'i përhapur' ose 'shumë i përhapur'. ndërsa vetëm 16.2% e konsideruan atë 'jo të përhapur' ose 'aspak të përhapur'. Sa i përket korrupsionit të madh, 81.5% e të anketuarve e konsiderojnë atë si 'të përhapur' ose 'shumë të përhapur', ndërsa 15,6% e konsiderojnë atë 'jo të përhapur' ose 'aspak të përhapur'.

Figura 22. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit (2023)



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë (N=2500); Korrupsioni i nivelit të ulët (N=2500)

Nocioni se korrupsioni i vogël dhe i madh janë të përhapura në vend duket të jetë universal, pavarësisht faktorëve të ndryshëm demografikë.


Të anketuarit u pyetën sërish për perceptimin e tyre për institucionet më të korruptuara. Tre institucionet më të përmendura në vitin 2023 ishin institucionet e drejtësisë (17.5%), institucionet e kujdesit shëndetësor (14.8%) policia (7.2%).

Është me interes të vëzhgojmë ndryshimet në këto renditje dhe përqindjen gjatë tre viteve të fundit, dhe të dhënat tregojnë një tendencë të qëndrueshme për institucionet më të korruptuara. Duhet evidentuar se ka vazhdimisht i vihet theksi institucioneve gjyqësore dhe atyre të kujdesit shëndetësor, të cilat qytetarët i kanë identifikuar vazhdimisht si shumë të korruptuara gjatë viteve 2021-2023. Më konkretisht, në vitin 2022, 20.6% e të anketuarve i kanë konsideruar institucionet gjyqësore dhe 18% institucionet e kujdesit shëndetësor si institucione problematike. Ndërkohë, policia ka mbajtur një nivel të qëndrueshëm prej rreth 7% gjatë gjithë periudhës trevjeçare që nga viti 2021 deri në vitin 2023.

PËRHAPJA E KORRUPSIONIT NË VITE

Kur analizojmë përhapjen e korrupsionit gjatë periudhës 2019-2023, gjetjet tregojnë se pjesa dërrmuese e të anketuarve e konsiderojnë korrupsionin e madh ashtu edhe atë të vogël si “të përhapur” dhe “shumë të përhapur”, me vlerësime mbi 77%.

Figura 23. Perceptimi i përhapjes së korrupsionit ‘I përhapur’ ose ‘Shumë i përhapur’ (2019–2023)



Baza: Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët, 2019 (N=2494); 2020 (N=2499); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); Korrupsioni i nivelit të lartë, 2019 (N=2495); 2020 (N=2499); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); 2023 (N=2500)

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar..


BESIMI NË NDJEKJEN PENALE TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT

Sipas sondazhit të vitit 2023, 62.8% e shqiptarëve nuk kanë besim në aftësinë e prokurorisë për të trajtuar rastet e korrupsionit të madh. Po ashtu, 56.8% shprehin mungesë besimi në ndjekjen me efikasitet të rasteve të korrupsionit të vogël.

Përveç pyetjeve për përhapjen e korrupsionit, pjesëmarrësve të sondazhit iu kërkua të vlerësonin besimin e tyre në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit.. Për këtë vlerësim u përdor një shkallë me 4 pikë, duke filluar nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim). Edhe këtu, të anketuarve iu kërkua të bënin dallimin midis rasteve që lidhen me korrupsion të vogël dhe atyre që kanë të bëjnë me korrupsion të madh.

Në fakt, të dhënat sugjerojnë se qytetarët priren të kenë më shumë besim te prokuroria kur bëhet fjalë për trajtimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët, por kanë më pak besim në efektivitetin e saj për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Ky hendek në nivelet e besimit tregon nuanca në perceptimin e publikut për aftësinë e institucionit për të trajtuar nivelet e ndryshme të korrupsionit, me një skepticizëm më të madh për rastet kur korrupsioni është i nivelit të lartë.

Figura 24. Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2023)



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë (N=2500); Korrupsioni i nivelit të ulët (N=2500).

Ndarja gjinore e të dhënave tregon se gratë kishin më shumë besim në aftësinë e prokurorisë për të trajtuar korrupsionin e vogël në krahasim me burrat. Konkretisht, 41.3% e grave u shprehën se kanë 'shumë besim ose 'besim', ndërsa për burrat kjo përqindje ishte pak më e ulët, në 39.3%. Gjithsesi, nuk kishte dallim të dukshëm mes grave dhe burrave në lidhje me trajtimin e rasteve të korrupsionit të madh nga ana e prokurorisë.

Nëse do të shqyrtonim tendencat sipas moshës, qytetarët më të rinj në moshë kishin më pak besim në aftësinë e prokurorisë për të trajtuar korrupsionin e vogël dhe të madh në krahasim me të anketuarit e tjerë më të vjetër në moshë.

Niveli arsimor duket se ndikon në nivelin e besimit të të anketuarve, ku ata me diplomë universitare ose pasuniversitare shprehin besim më të madh në efektivitetin e prokurorisë në trajtimin e korrupsionit të vogël (40.9%) në krahasim me ata me arsim të mesëm (39.1%).


Për sa i përket sektorit të punësimit, të anketuarit në sektorin publik kishin më shumë besim në aftësinë e prokurorisë për të trajtuar si korrupsionin e vogël ashtu edhe atë të madh, krahasuar me të anketuarit e tjerë të punësuar në sektorin privat.

BESIMI NË NDJEKJEN PENALE TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT NË VITE

Besimi në ndjekjen penale të korrupsionit të madh dhe të vogël është përmirësuar gjatë viteve 2017-2023, me një tendencë të dukshme në rritje të besimit të qytetarëve për efektivitetin e prokurorisë në trajtimin e të formave të korrupsionit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, të anketuarit vazhdimisht kishin më shumë besim lartë në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël sesa atyre të korrupsionit të madh, me vlerësime që varionin mes 34% dhe 41%, ndërsa rezultatet për korrupsionin e madh varionin nga 25% në 34%.

Figura 25. Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2017–2023)



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë: 2017 (N=1639); 2018 (N=1644); 2019 (N=2490); 2020 (N=2494); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); 2023 (N=2500). Korrupsioni i nivelit të ulët: 2017 (N=1639); 2018 (N=1644); 2019 (N=2461); 2020 (N=2496); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); 2023 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.


EFIKASITETI I INSTITUCIONEVE KOMBËTARE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në këtë sondazh u përfshi një pyetje që vlerëson perceptimin e publikut për efektivitetin e secilit institucion publik në luftën kundër korrupsionit në vend. Të dhënat tregojnë se Struktura e Posaçme e Anti-Korrupsionit (SPAK) është institucioni që qytetarë mendojnë se është më efikas në trajtimin e korrupsionit, me 60.9% të të anketuarve që shprehen se kanë besim ose shumë besim.

Megjithatë, për institucionet e tjera në vend, niveli i besimit të qytetarëve ra nën 50%. Më konkretisht, rreth 45.3% kishin besim apo shumë besim te Kontrolli i Lartë i Shtetit, 37.4% tek Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), 35.9% te Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion dhe 35% te Njësitë e Auditimit të Brendshëm të vetë institucioneve publike. Këto përqindje nënvizojnë hendekun e madh në nivelin e besimit që qytetarët kanë te këto institucione për luftën kundër korrupsionit.

Në fakt, këto gjetje përputhen me rezultatet e sondazheve të mëparshme në lidhje me besimin dhe llogaridhënien në institucione. Të dhënat tregojnë vazhdimisht se Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) gëzon një nivel të lartë besimi nga qytetarët, ndërkohë që institucionet e tjera në vend kanë një nivel më të kufizuar besimi të publikut.

Figura 26. Besimi tek institucionet dhe strukturat publike kombëtare për trajtimin e rasteve të korrupsionit (2023)



Baza: (N=2500)

Të dhënat sipas ndarjes gjinore tregojnë se nuk ka dallime të mëdha mes grave dhe burrave për sa i përket besimit në aftësinë e institucioneve vendase për të luftuar korrupsionin.

Megjithatë, kur të dhënat ndahen sipas grupmoshave, kemi një prirje që duhet evidentuar. Të anketuarit më të rinj në moshë kishin një nivel më të ulët besimi tek të gjitha institucionet krahasuar me të anketuarit e tjerë më të vjetër. Për shembull, 37.6% e të anketuarve të moshës 18-25 vjeç shprehën besim tek KLSH, krahasuar me 44.9% të të anketuarve të moshës 66 vjeç e lart.

E njëjta tendencë vihet re edhe kur analizojmë të dhënat sipas nivelit të arsimit të të anketuarve. Qytetarët me diplomë universitare ose pasuniversitare priren të kenë më shumë besim tek institucionet vendase në krahasim me ata me nivele më të ulëta arsimore.


Po ashtu, punonjësit e sektorit publik shfaqën më shumë besim krahasuar me ata që punojnë në sektorin privat. Për shembull, 71.6% e punonjësve të sektorit publik ose kishin besim ose shumë besim te Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) për luftën kundër korrupsionit, ndërkohë që kjo shifër për ata që punojnë në sektorin privat është 58.9%.

PËRVOJA PERSONALE ME KORRUPSIONIN

Qytetarët shqiptarë u pyetën nëse kanë qenë vetë dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsioni në institucionet publike. Të dhënat tregojnë se shumica e të anketuarve nuk kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti të korrupsionit – 14.7% raportojnë se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel të qeverisë qendrore dhe 20.3% në nivel të qeverisjes vendore.

Këtu kemi një krahasim pozitiv me sondazhin e mëparshëm. Në vitin 2022, 15.4% e shqiptarëve raportuan se ishin dëshmitarë të korrupsionit në nivel të qeverisë qendrore dhe 22% raportuan korrupsion në nivel vendor. Prandaj, sondazhi tregon një rënie modeste të përqindjes së të anketuarve që kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në të dy nivelet e qeverisjes gjatë periudhës 2022-2023.

Figura 27. Përvoja personale me korrupsionin (2023)



Baza: Qeveria qendrore (N=2500); qeveria vendore (N= 2500)


Të dhënat sipas ndarjes gjinore tregojnë se rreth 13.4% e grave dëshmuar raste të korrupsionit në qeverinë qendror në vitin 2023, ndërkohë që kemi një shifër pak më të lartë prej 17.5% të raportuar nga burrat. Në nivel vendor, 17.5% e grave raportuan se ishin dëshmitarë të korrupsionit në nivel vendor, ndërsa 23.2% e burrave kishin hasur të njëjtën përvojë.

Analiza sipas grupmoshës tregon se grupmosha 36-45 vjeç është dëshmitare e më shumë rasteve të korrupsionit, me shifra që janë 19.8% në nivel qendror dhe 23.9% në nivel vendor. Po ashtu, punonjësit e sektorit privat raportuan se ishin dëshmitarë të korrupsionit si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendore më shpesh sesa homologët e tyre të sektorit publik.

PËRVOJA PERSONALE ME KORRUPSIONIN NË VITE

Vazhdimisht gjatë viteve të marra në studim, një përqindje më e vogël e të anketuarve raportojnë se kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit që ndodhte në nivel qendror në krahasim me nivelin atë vendor, ku kemi një dallim me të paktën 5 p.p. mes tyre për çdo vit.

Figura 28. Përvoja personale me korrupsionin (2016–2023)




Baza: Për qeverinë qendrore, 2016 (N=1633); 2017 (N=1638); 2018 (N=1631); 2019 (N=2487); 2020 (N=2483); 2021 (N=2489); 2022 (N=2491); 2023 (N=2500). Për qeverinë vendore, 2016 (N=1633); 2017 (N=1639); 2018 (N=1631); 2019 (N=2487); 2020 (N=2483); 2021 (N=2490); 2022 (N=2487); 2023 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar..

PËRDORIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në vitin 2023, 39% e pjesëmarrësve të këtij sondazhi thanë se kanë përdorur shërbime nga institucionet publike të nivelit qendror, ndërkohë që 61.0% nuk i kanë marrë këto shërbime. Pothuajse e kundërta vihet re për shërbimet e qeverisjes vendore, ku 60.7% e të anketuarve i kanë përdorur këto shërbime dhe 39.3% jo. Kjo evidenton se qytetarët shqiptarë priren të përdorin më shumë shërbimet e qeverisjes vendore sesa ato qendrore..

Figura 29. Shërbimet e marra në nivel qendror dhe vendor (2023)



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2500); Për qeverinë vendore (N=2500)

Të dhënat sipas ndarjes gjinore tregojnë se një përqindje më e lartë e burrave në krahasim me gratë kanë përdorur shërbimet publike, qoftë në nivel qendror apo vendor. Më konkretisht, në vitin 2023, 41.6% e meshkujve morën shërbime publike nga qeveria qendrore, gjë që e bënë 36.3% e grave. Për sa i përket shërbimeve të nivelit vendor, 63.8% e burrave i përdornin ato, krahasuar me 57.7% të grave.

Kur analizojmë rezultatet sipas grupmoshës, është e qartë se shërbimet publike përdoren kryesisht nga individë të grupmoshës 26-45 vjeç, të cilët tejkaluan përqindjet e përdorimit të grupmoshave të tjera.

Punonjësit në sektorin publik raportuan përqindje pak më të lartë të përdorimit të shërbimeve të qeverisë qendrore krahasuar me homologët e tyre në sektorin privat, përkatësisht me 44.9% dhe 39.7%. Megjithatë, nuk ka dallime të mëdha në përdorimin e shërbimeve të nivelit vendor, ku përqindjet janë 62.6% për punonjësit e sektorit publik dhe 61.3% për ata në sektorin privat.


Kur i shqyrtojmë të dhënat sipas vendbanimit, na del një tendencë e qartë, ku të anketuarit nga zonat urbane prirën të përfitojnë më shumë nga shërbimet e qeverisë qendrore dhe ato të nivelit vendor sesa të anketuarit e zonave rurale. Kështu, 40.5% e qytetarëve që jetojnë në zonat urbane përdornin shërbimet e qeverisë qendrore, në dallim nga 34.7% të atyre nga zonat rurale. Po ashtu, rreth 62.7% e banorëve të zonave urbane përdorën shërbimet e qeverisjes vendore krahasuar me 55.1% të banorëve të zonave rurale.

PËRHAPJA E RYSHFETIT

Të dhënat nxjerrin në pah një uniformitet në përqindjen e të anketuarve që kanë përdorur shërbime në nivel qendror dhe vendor dhe kanë pranuar se kanë paguar ryshfet. Më konkretisht, 29.9% e atyre që kanë marrë shërbime të nivelit qendror dhe 29.8% e të anketuarve që kanë përdorur shërbimet e qeverisë vendore raportojnë se kanë paguar ryshfet.

Krahasuar me sondazhin e vitit 2022, ka pasur një rënie të lehtë të këtyre shifrave. Në vitin 2022, 30.9% e qytetarëve raportuan se kishin paguar ryshfet për marrjen e një shërbimi në qeverinë qendrore dhe 32.7% për shërbimet e nivelit vendor. Të dhënat e sondazhit të 2023 tregojnë një rënie, me 29.9% për shërbimet e qeverisë qendrore dhe 29.8% për shërbimet e qeverisjes vendore.

Figura 30. Ryshfet paguar për shërbim – përdoruesit e shërbimeve në nivel qendror dhe vendor (2023)



Baza: Për qeverinë qendrore (N=996); Për qeverinë vendore (N=1460)

Të dhënat sipas ndarjes gjinore nuk evidentuan dallime të mëdha midis grave dhe burrave kur bëhet fjalë për dhënien e ryshfetit. Përqindja e grave dhe burrave që dhanë ryshfet kur merrnin shërbime të qeverisë qendrore apo vendore mbeti e njëjtë.

Si për kontrast, niveli arsimor duket se është faktor përcaktues për rastet e ryshfetit. Për sa i përket shërbimeve të qeverisë në nivel qendror, 34.3% e qytetarëve me nivel më të ulët arsimor pranuan se kishin paguar ryshfet, krahasuar me 25.3% të qytetarëve me nivel universitar ose pasuniversitar. Kjo tendencë vlen edhe për shërbimet e nivelit vendor, me 35.6% të të anketuarve me nivel më të ulët arsimor që pranuan se kishin dhënë ryshfet krahasuar me 23.5% të atyre me të paktën arsim universitar.

Qytetarët e punësuar në sektorin privat raportuan një përqindje më të lartë të dhënies së ryshfetit gjatë marrjes së shërbimeve publike në krahasim me ata që punojnë në sektorin publik. Konkretisht, 30.7% e të anketuarve të punësuar në sektorin privat thanë se kishin dhënë ryshfet për shërbimet e qeverisë qendrore, ndërsa shifra qëndron në 21.4% për ata në sektorin publik. Mbetet e pasigurt nëse kjo mospërputhje është për shkak të ndërgjegjësimit më të madh të punonjësve të sektorit publik në lidhje me marrjen e shërbimeve të caktuara apo mosraportimit për shkak të lidhjes së tyre me institucionet publike.

Pabarazi e ngjashme vihet re edhe kur analizojmë dallimet sipas vendbanimit. Të anketuarit që banojnë në

zonat rurale raportuan përqindje më të lartë të dhënies së ryshfetit në krahasim me ata që vijnë nga zonat urbane. Për shembull, 35.3% e të anketuarve në zonat rurale pranuan se kishin paguar ryshfet për shërbimet e qeverisë qendrore, në kontrast me 28.2% të atyre në zonat urbane. Për sa i përket shërbimeve të qeverisjes vendore, 35% e të anketuarve në zonat rurale raportuan se kishin dhënë ryshfet, ndërkohë që kjo shifër është 28.2% për ata që jetojnë në zonat urbane.

ARSYET E DHËNIES SË RYSHFETIT

Të anketuarit që deklaruan se kishin dhënë ryshfet gjatë vitit 2023, u pyetën më pas për arsyet që i shtynë drejt një veprimit të tillë. Shumica, 57.8%, deklaruan se u ishte kërkuar një gjë e tillë. 21.7% përmendën se besonin se dhënia e ryshfetit ishte një mënyrë për të shprehur mirënjohjen për shërbimin e marrë, ndërsa 14.8% thanë se kishin paguar ryshfet për të siguruar shërbim më të mirë herën tjetër kur të kishin nevojë.

Tabela 10: Arsyet për dhënien e ryshfetit (2023)


	N	%
Ma kërkuar ryshfetin	133	57.8%
E dhashë vetë, që të marr një shërbim më të mirë herës tjetër	50	21.7%
E dhashë vetë, si mirënjohje për shërbimin e marrë	34	14.8%
Tjetër*	13	5.7%
Gjithsej	230	100.0%

*Tjetër: "Nuk të shërbejnë nëse nuk u jep ryshfet"; "për të marrë shërbim më të shpejtë".

PËRHAPJA E RYSHFETIT NË VITE

Gjatë viteve 2016-2023, përqindja në përgjithësi e të anketuarve që pranojnë se kanë dhënë ryshfet gjatë marrjes së shërbimeve nga qeverisja qendrore apo ajo vendore ka qenë në nivel të qëndrueshëm.

Figura 31. Përqindja e përhapjes së ryshfetit (2016–2023)




Baza: Baza: Niveli vendor: 2016 (N=838); 2017 (N=916); 2018 (N=924); 2019 (N=1744); 2020 (N=1575); 2021 (N=1672); 2022 (N=1460); 2023 (N=920). Niveli qendror: 2016 (N=406); 2017 (N=561); 2018 (N=648); 2019 (N=1518); 2020 (N=1046); 2021 (N=973); 2022 (N=996); 2023 (N=920)

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

RAPORTIMI I RASTEVE TË RYSHFETIT

Vetëm 10.9% e të anketuarve pranojnë se kanë raportuar rastet e korrupsionit tek autoritetet ose institucionet e tjera, ndërkohë që një shumicë dërrmuese prej 89.1%, thanë se nuk e kanë bërë një gjë të tillë.


Figura 32. Rastet e ryshfetit të raportuar tek autoritetet/institucionet (2023)



Baza: N=230


Ata që kishin paguar ryshfet dhe kishin refuzuar ta raportonin atë u pyetën për arsyet e mosraportimit. Shumica, 39%, thanë se ishte thjesht një praktikë e zakonshme në vend për të siguruar shërbime publike (qendrore apo lokale). 32.2% mendonin se raportimi i rasteve të tilla ishte i padobishëm dhe se askush nuk do ta trajtonte këtë çështje. Një tjetër grup, 8.3% thanë se kishin frikë nga hakmarria nga raportimi tek ndonjë autoritet, ndërsa 7.3% shprehën pasiguri se ku ose kujt mund t'i raportonin raste të tilla.

Figura 33. Arsyet e mosraportimit të korrupsionit në institucionet publike (2023)



Baza: N=205

Këto shifra tregojnë se arsyet pse njerëzit nuk raportojnë rastet e korrupsionit lidhen kryesisht me mungesën e besimit tek autoritetet ose me besimin se korrupsioni është një mjet efikas për përshpejtimin e marrjes së shërbimeve.



7. Pjesëmarrja Qytetare


Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes pasqyron cilësinë e qeverisjes dhe gjendjen e demokracisë në një vend. Në këtë kapitull analizohet angazhimi i qytetarëve me institucionet publike. Ashtu si edhe në vitet e kaluara, pyetjet e sondazhit matin pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike dhe arsyet për mospjesëmarrjen në vendimmarrje. Sondazhi vlerëson edhe përdorimin e një platforme të veçantë konsultimi online 'konsultimipublik.gov.al' për të marrë informacione ose për të dhënë sugjerime e mendime për projektligje ose politika. Po ashtu, ai thellohet në aktivitete të angazhimit qytetar si pjesëmarrja në tubime, gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare dhe mendimi për t'u larguar brenda ose jashtë vendit. Nga ana tjetër, trajtohen edhe çështje të sigurisë në jetën e përditshme dhe faktorët që ndikojnë në pasiguri. Në vitin 2023, u prezantua një pyetje e re, që ka të bëjë me drejtimet ku të anketuarit besojnë se qeveria duhet të fokusohet në pesë vitet e ardhshme.

Pjesëmarrja në Vendimmarrje

Në vitin 2023, përqindja e popullsisë shqiptare që kishte interes për të marrë pjesë në vendimmarrje ishte pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2022, duke shkuar nga 45.3% në 45.2%. Një shumicë e konsiderueshme e qytetarëve shqiptarë shprehin mendimin se u mungojnë mundësitë e duhura për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike, veçanërisht në nivelin qendror.

Gjatë vitit 2023, 45.2% e të anketuarve shprehën interesin për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes së institucioneve publike, shifër e njëjtë me atë të vitit 2022 (45.3%).


Figura 34. Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike (2023)



Baza: N = 2493

Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse e treguan një përqindje thuajse e barabartë e grave (44.9%) dhe burrave (45.5%). Të anketuarit që prireshin të shprehnin interes për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse ishin zakonisht individë më të rinj, më të arsimuar, të punësuar me të ardhura më të larta në krahasim me grupet e tjera. Për të dhëna më të hollësishme, shihni Tabelën 14 në fund të kapitullit.

Për sa i përket perceptimeve për mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrje, vetëm 27.3% e të anketuarve i kanë konsideruar mundësitë në nivel të qeverisë qendrore të mjaftueshme, shumë afër rezultatit të vitit 2022 (27.4%). Në nivel vendor, 36.9% besonin se mundësitë ishin të përshtatshme, sërish pothuajse e njëjta përqindje me atë të vitit 2022 (37.9%).

Figura 35. Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2023)


Baza: Për qeverinë qendrore N=2485; Për qeverinë vendore N=2488.

Në nivel të qeverisë qendrore, mundësitë që perceptohen për pjesëmarrje për gratë (26.1%) ishin pak më të ulëta në krahasim me burrat (28.6%), me një diferencë prej 2.5 pikë përqindje. Megjithatë, në nivel vendor, gra prireshin më shumë nga burrat të mendonin se kishte mundësi për pjesëmarrje në vendimmarrje, me një diferencë prej 3.1 pikë përqindjeje. Individët më të rinj në moshë, ata më të arsimuar, të punësuarit dhe ata me të ardhura më të larta ishin më të prirur të thoshin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen qendrore dhe vendore. Për të dhëna më të hollësishme, shihni Tabelën 14 në fund të këtij kreu.

MUNDËSITË PËR PJESEMARRJE NË VENDIMMARRJE NË VITE

Figura 36 ilustron përqindjen e të anketuarve që thonë se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, nga viti 2016 deri në vitin 2023.

Nga viti 2019 deri në 2023, perceptimi i mundësive për të dy nivelet qeveritare ishte mjaft i qëndrueshëm. Në nivel të qeverisjes qendrore, përqindja mbeti relativisht e qëndrueshme, duke pësuar një rënie prej 2 pikë përqindjeje nga 29% në 2019 në 27% në 2023. Po ashtu, në nivel të qeverisjes vendore, kishte një tendencë të qëndrueshëm pikësh me një rënie vetëm 4 pikë përqindjeje nga 41% në 2019 në 37% në 2023. Megjithatë, perceptimi i mundësive të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse ka qenë vazhdimisht më i lartë në nivel vendor krahasuar me nivelin qendror.

Figura 36. Mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen (2016–2023)

Baza: Niveli qendror, 2016 (N=1633); 2017 (N=1634); 2018 (N=1630); 2019 (N=2480); 2020 (N = 2482); 2021 (N = 2490); 2022 (N = 2490); 2023 (N = 2485). Nivel vendor 2016 (N=1634); 2017 (N=1630); 2018 (N=1638); 2019 (N=2463); 2020 (N = 2491); 2021 (N = 2494); 2022 (N = 2490); 2023 (N = 2488).


***Shënim:** Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar..

PROCESET E KONSULTIMIT

Në vitin 2023, ashtu si vitin e kaluar, 10.9% e shqiptarëve të anketuar u ftuan të përfshiheshin në procese konsultimi nga institucionet publike në nivel të qeverisjes qendrore. Njëkohësisht, një përqindje më e lartë, 18.5%, ka marrë pjesë për procese konsultimi në nivel vendor. Arsyja kryesore për mungesën e pjesëmarrjes së tyre është mosbesimi në vetë mekanizmat e konsultimit.

Rreth një në dhjetë të anketuar (10.9%) u ftuan në proceset e konsultimit të qeverisë qendrore, shifër e ngjashme me atë të vitit 2022 prej 11.8%. Në nivel vendor, 18.5% kanë marrë pjesë, edhe kjo një përqindje shumë e ngjashme me atë të një viti më parë (18.6%). Në Tabelën 15 në fund të këtij kreu jepen informacione të hollësishme sipas ndarjes demografike të këtyre përgjigjeve.

Figura 37. Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2023)




Baza: Për qeverisjen qendrore N=2486; për qeverisjen vendore N=2483.

PJESËMARRJA NË KONSULTIME NË VITE

Në Figurën 38 tregohet tendenca e ftesave të raportuara për të marrë pjesë në proceset e konsultimit si në nivelin e qeverisjes qendrore ashtu edhe në atë vendore nga viti 2016 deri në vitin 2023. Në nivel të qeverisjes qendrore, në përgjithësi ka pasur ndryshime të vogla në perceptimin publik, nga 13% në 2019 në 11% në vitin 2023, me disa luhajtje vitet në mes. Ndërkohë, në nivel të qeverisjes vendore, ka pasur një rënie të vazhdueshme nga 24% në 2019 në 19% në 2023. Shifrat sugjerojnë një nivel të krahasueshëm angazhimi në proceset e konsultimit në të dy nivelet e qeverisë gjatë kësaj periudhe, ka pasur, gjithsesi, më shumë ftesa për proceset e konsultimit në nivel vendor gjatë këtyre viteve.

Gjatë periudhës në fjalë, pjesëmarrja aktuale në proceset vendimmarrëse mbeti dukshëm e ulët (në mënyrë të vazhdueshme nën 25%) krahasuar me mundësitë e perceptuara për pjesëmarrje. Ndër arsyet kryesore të përmendura nga shqiptarët për mospjesëmarrjen e tyre në proceset e konsultimit nga viti 2016 deri në 2023 ishin mungesa e besimit se përfshirja e tyre do të sillte ndryshimin, pritshmëria se të tjerët do të merrnin pjesë dhe perceptimi se mekanizma apo procedurat e konsultimit ishin të papërshtatshme.

Figura 38. Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016–2023)




Baza: Nivel vendor: 2016 (N=1624); 2017 (N=1635); 2018 (N=1629); 2019 (N=2482); 2020 (N=2486); 2021 (N=2494); 2022 (N=2492); 2023 (N=2483). Nivel qendror: 2016 (N=1631); 2017 (N=1635); 2018 (N=1630); 2019 (N=2483); 2020 (N = 2486); 2021 (N = 2494); 2022 (N = 2493); 2023 (N=2486).

*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

Në vitin 2023, 9.8% e të anketuarve raportuan se kishin marrë pjesë në procese konsultimi të organizuara nga qeveria qendrore, krahasuar me 9.9% në vitin 2022. Ndërkohë, 15.3% raportuan se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga bashkia, krahasuar me 16.7% në 2022. Tabela 15 në fund të kapitullit jep informacione më të hollësishme sipas ndarjes demografike të përgjigjeve.

Figura 39. Pjesëmarrja në takime konsultimi (2023)



Baza: Për qeverisjen qendrore N = 2353; për qeverisjen vendore N = 2377.

Arsyet kryesore të përmendura për mungesën e pjesëmarrjes ishin: mungesa e besimit në proceset e konsultimit (30.3%), ndjekur nga mendimi se duhet të shkojnë të tjerët (25.2%) dhe perceptimi i mungesës së mekanizmave të duhur të konsultimit (15.3%). Arsyet e tjera të përmendura shpesh përfshinin perceptimin se proceset e konsultimit ishin ekskluzive për anëtarët e partisë ose takime formale që japin rezultate të pakta.


Tabela 11 Arsyet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2023

	N	%
Mendoj që duhet të shkojnë të tjerët	494	25.2%
Nuk besoj tek këto procese konsultuese	593	30.3%
Nuk kam pasur informacion mbi temën që diskutohej	228	11.6%
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit ose të aksesoja online takimin konsultues	156	8.0%
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	299	15.3%
Tjetër*	190	9.7%

* Përgjigje të shpeshta në kategorinë "tjetër" ishin: "[proceset e konsultimit] janë të hapura vetëm për anëtarët e partisë", "[proceset e konsultimit] janë vetëm takime formale, pa rezultate", mungesa e arsimit, probleme shëndetësore dhe mosha e thyer.

Në vitin 2023, 14.4% e të anketuarve thanë se ata e kishin përdorur portalin 'www.konsultimipublik.gov.al' për të marrë informacione apo për të dhënë mendime për projektligje apo strategji, e krahasueshme me nivelin prej 18.1% të vitit 2022.

Figura 40. Përdorimi i portalit "Konsultimipublik.gov.al" në vitin 2023



Baza: N=2487

Është e rëndësishme të theksohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve të portalit 'www.konsultimipublik.gov.al' ka mbetur vazhdimisht i ulët gjatë gjithë këtyre viteve.


Nuk kishte dallime të mëdha në përdorimin e portalit sipas ndarjes gjinore, pasi shkalla e angazhimit të meshkujve dhe femrave ishte e ngjashme. Grupe të caktuara, si të rinjtë, individët me arsim të lartë dhe ata që punojnë në sektorin publik, treguan nivele relativisht më të larta përdorimi brenda demografisë së tyre. Gjithsesi, angazhimi i përgjithshëm në të gjitha segmentet mbeti i kufizuar. Për të dhëna më të hollësishme, referojuni Tabelës 15 në fund të këtij kreu.

PJESËMARRJA NË NJË DEMONSTRATË/TUBIM APO NËNSHKRIM I NJË PETICIONI

Në popullatën e anketuar, përqindja e pjesëmarrjes në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni ra nga 32.2% në vitin 2022 në 25.2% në 2023.

Në vitin 2023, 25.2% e të anketuarve të angazhuar në aktivitete të tilla shënoi një rënie prej 7 pikë përqindje nga viti 2022 (32.2%).

Figura 41. Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni në vitin 2023



Baza: N=2471


Ashtu si në vitin 2022, arsyeja kryesore e dhënë për pjesëmarrjen në një demonstratë/tubim ose për nënshkrimin e një peticioni në 2023 ishte 'interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj' (54,7%), i ndjekur nga 'interesi personal' (27,4%), 'militantizmi (për mbështetje politike)' (14,5%) dhe 'presion i shokëve/të njohurve' (3,1%). Nga të anketuarit është përmendur shpesh mungesa e kohës si pengesë kryesore.

Të dhënat tregojnë nivele të ndryshme pjesëmarrjeje sipas grupeve demografike. Një përqindje më e madhe e burrave (26.6%) thanë se kishin marrë pjesë në demonstrata ose kishin nënshkruar peticione në krahasim me gratë (23.6%). Të anketuarit më të rinj në moshë, ata me arsim të lartë, studentët dhe ata me të ardhura mujore midis 60,001–80,000 lekë kishin përqindje relativisht më të larta pjesëmarrjeje në demonstrata ose në nënshkrime të peticioneve në vitin 2023.

PJESËMARRJA NË NJË DEMONSTRATË/TUBIM APO NËNSHKRIM I NJË PETICIONI NË VITE

Gjatë viteve të marra në studim, ka pasur luhajtje në pjesëmarrjen në demonstrata/tubime ose për nënshkrime peticioni, me një kulmin që arrihet në vitin 2022 me 32% dhe më pas me një rënie në 25% në 2023. Shqiptarët e anketuar kanë marrë pjesë në këto aktivitete kryesisht për shkak të interesave të përbashkëta me komunitetin ku jetojnë dhe për motive personale.

Figura 42. Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni (2016–2023)




Baza: 2023 (N=2471); 2022 (N=2490); 2021 (N=2500); 2020 (N=2483); 2019 (N=2479); 2018 (N=1636); 2017 (N=1637); 2016 (N=1597)

*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

GATISHMËRIA PËR T'U ANGAZHUAR NË PUNË VULLNETARE

Në vitin 2023, gatishmëria e qytetarëve të anketuar për t'u përfshirë në punë vullnetare ra paksa nga 61.5% në vitin 2022 në 58.6% në 2023.

Figura 43. Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare (2023)



Baza: N = 2476


Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare ishte mjaft e ngjashme mes femrave (59.1%) dhe meshkujve (58.1%). Në përgjithësi, individët më të rinj, ata me arsim të lartë, studentët dhe të punësuarit shfaqën një prirje më të madhe për t'u angazhuar në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Nga ana tjetër, grupmosha më e vjetër, ata me nivele më të ulëta arsimore dhe individët në pension prireshin të ishin më pak të gatshëm për angazhim në punë vullnetare.

LARGIMI NGA VENDBANIMI AKTUAL

38.3% e popullsisë shqiptare dëshironte të largohej nga vendi për të emigruar në vitin 2023 – shifër kjo e njëjtë me atë të vitit 2022. Arsyet kryesore të dëshirës për të shkuar në një shtet tjetër janë punësimi, paga më të mira dhe mundësi më të mira arsimimi.

Plot 38.3% e të anketuarve (38.4% gra dhe 38.1% burra) raportuan se donin të emigronin drejt një shteti tjetër në vitin 2023 – shifër e njëjtë me atë të vitit 2022 (38.3%). Ndërkohë, 5.5% e të anketuarve (6.1% e femrave dhe 4.9% e meshkujve) kanë deklaruar se duan të zhvendosen në zona të tjera brenda vendit. Pjesa e mbetur prej 56.2% e të anketuarve thanë se nuk po planifikonin të largoheshin nga vendbanimi i tyre në vitin 2023.

Figura 44. Largimi nga vendbanimi aktual (2023)



Baza: N=2452


Të anketuarit e këtij sondazhi, që thanë se dëshironin të largoheshin nga vendbanimi i tyre aktual drejt një vendi tjetër, renditën si arsyt kryesore 'punësimin, pagat më të larta ose ushtrimin e profesionit për të cilin kishin studiuar' (32%), 'mundësi më të mira arsimimi' (6%), 'bashkimi me anëtarët e familjes' (4%) dhe 'marrja e trajtimit shëndetësor' (3%). Arsyet e tjera kishin të bënin me jetesën në vende më të sigurta, marrjen e shërbimeve më të mira, si dhe largimin nga korrupsioni dhe padrejtësia. Të anketuarit më të rinj ishin kishin më shumë dëshirë të emigronin, veçanërisht ata të moshës 18-25 vjeç (57.4%) si dhe studentët (50%).

LARGIMI NGA VENDBANIMI AKTUAL NË VITE

Siç tregohet në Figurën 45, pothuajse gjysma (46%) e shqiptarëve të anketuar dëshironin të emigronin drejt një vendi tjetër në vitin 2019, gjë që ka rënë gradualisht çdo vit që atëherë, duke kulmuar me rënien prej 8 p.p. në vitin 2023. Ndërkohë, përqindja e shqiptarëve që dëshironin të shpërnguleshin në zona të tjera brenda vendit ka mbetur në të njëjtin nivel që nga viti 2019.

Disa nga arsyt kryesore të përmendura gjatë kësaj periudhe për emigrimin drejt një vendi tjetër ishin mundësitë më të mira të jetës, faktorët ekonomikë dhe zhvillimi profesional.

Figura 45. Largimi nga vendbanimi aktual (2019-2023)



Baza: 2023 (N=2452); 2022 (N=2488); 2021 (N=2495); 2020 (N=2481); 2019 (N=2489).

*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.


SIGURIA NË JETËN E PËRDITSHME

67.6% e qytetarëve të anketuar thonë se nuk ndjehen të sigurt në jetën e përditshme, me një rritje të ndjeshme prej 8 p.p. nga niveli 59.3% në 2022. Tre arsyt kryesore të ndjenjës së pasigurisë janë kriminaliteti, shëndetësia pa cilësi e standard, dhe pasiguria e vendit të punës.

Plot 67.6% e të anketuarve thanë se nuk ndiheshin të sigurt në jetën e përditshme, me një rritje të konsiderueshme prej 8 pikë përqindje krahasuar me 59.3% të raportuar për vitin 2022. Pjesa tjetër, 32.4%, thanë se ndjeshin të sigurt.

Në figurën më poshtë jepet perceptimi i qytetarëve për sigurinë e tyre siç është raportuar në sondazhet e viteve 2016-2023. Ka një zhvendosje të dukshme nga viti 2019 në 2023, ku përqindja e të anketuarve që thonë se ndjehen të sigurt bie nga 35% në 32%. Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që perceptojnë mungesën e sigurisë u rrit nga 65% në 2019 në 68% në 2023.

Figura 46. Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme (2016-2023)



Baza: 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=2500); 2020 (N=2492); 2021 (N=2490); 2022 (N=2487); 2023 (N=1122).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

Kur u pyetën për arsyet e ndjenjës së pasigurisë në vitin 2023, faktorët më shpesh të përmendur nga të anketuarit ishte kriminaliteti (72%), ndjekur nga shëndetësia pa cilësi e standard (65%) dhe padrejtësia (32%). Arsye të tjera që u përmendën për pasigurinë ishin pasiguria e vendit të punës (30%), politika (21%) dhe pabarazia në ndarjen e pasurisë (19.4%). Në Tabelën 12 më poshtë jepet renditja e plotë e arsyeve për ndjenjën e pasigurisë së përditshme gjatë viteve 2016-2023.

Tabela 12: Faktorët për ndjenjën e pasigurisë (2016–2023)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Kriminaliteti (vjedhjet, grabitjet)	49%	58%	71%	67%	59%	73%	61%	72%
Shëndetësia pa cilësi e standard	11%	30%	50%	49%	49%	43%	45%	65%
Pasiguria e vendit të punës	11%	30%	50%	49%	49%	43%	45%	30%
Padrejtësia	11%	32%	45%	36%	37%	35%	39%	32%
Ndjenja e pasigurisë për shkak të fatkeqësive natyrore (p.sh., tërmetet, pandemia)	x	x	x	x	27%	22%	13%	5%
Politika	5%	29%	45%	28%	23%	17%	26%	21%
Pabarazia në pasuri	3%	23%	23%	16%	18%	15%	18%	19%
Ndotja	3%	12%	20%	17%	12%	16%	13%	16%
Përdorimi i lëndëve narkotike	6%	23%	29%	15%	9%	13%	11%	11%
Trafiku	7%	11%	13%	13%	8%	13%	8%	11%
Dhuna në familje	3%	15%	19%	7%	6%	9%	9%	4%
Mungesa e lirisë së fjalës	1%	5%	11%	4%	3%	3%	5%	5%
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtjes kur raportohen shkeljet	1%	6%	12%	3%	3%	4%	6%	5%
Diskriminimi për shkak të gjinisë, besimit fetar, pasurisë, etj.	x	5%	7%	3%	1%	1%	3%	1%

DREJTIMET KRYESORE NË PUNËN E QEVERISË

Kur u pyetën për drejtimet kryesore për qeverinë në pesë vitet e ardhshme, të anketuarit theksuan kryesisht shëndetësinë (54%) dhe arsimin (38%) si drejtime të rëndësishme që duan vëmendje, ndjekur nga turizmi, infrastruktura e transportit dhe bujqësia.

Në këtë sondazh të anketuarit u pyetën se cilat nga drejtimet kryesore të mëposhtme duhet të jenë prioritet në punën e qeverisë në pesë vitet e ardhshme. Më shumë se gjysma e të anketuarve zgjedhën shëndetësinë (54%) si drejtim kryesor, pasuar nga arsimit (38%). Drejtimet e tjera të përmendura më shumë ishin turizmi (21%), infrastruktura e transportit (21%) dhe bujqësia (16%). Në tabelën e mëposhtme jepet një renditje e plotë e drejtimeve kryesore që të anketuarit besonin se duhet të bëhen fokusi kryesor i punës së qeverisë për pesë vitet e ardhshme.

Tabela 13: Drejtimet kryesore për punën e qeverisë (2023) (me disa zgjedhje)

Drejtimet kryesore	N	%
Shëndetësia	605	54%
Arsimi	428	38%
Turizmi	240	21%
Infrastruktura e transportit (tokësor, detar, ajror)	234	21%
Bujqësia	185	16%
Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (bizneset e vogla dhe të mesme)	113	10%
Energjia (burime të rinovueshme (diellore, erë, etj.))	97	9%
Mjedisi dhe ndryshimet klimatike	94	8%
Digjitalizimi	73	7%
Kultura	66	6%
Industria (e lehtë, e rëndë)	51	5%

Tabela 14: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2023)

	Interesi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes	Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje	
		Qeveria qendrore	Qeveria vendore
Gjithsej	45%	27%	37%
Gjinia			
Gra	45%	26%	35%
Burra	45%	29%	39%
Mosha			
18–25 vjeç	51%	28%	38%
26–35 vjeç	56%	36%	45%
36–45 vjeç	48%	31%	41%

		Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje		
		Interesi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes	Qeveria qendrore	Qeveria vendore
46–55 vjeç		41%	26%	37%
56–65 vjeç		35%	18%	28%
66 vjeç e sipër		22%	11%	15%
Niveli i Arsimit				
Me arsim deri 8/9-vjeçar		37%	26%	33%
Me arsim të mesëm		45%	25%	34%
Me arsim universitar		50%	30%	41%
Statusi i Punësimit				
I/E punësuar	Gjithsej	48%	29%	40%
	Sektori publik	50%	33%	45%
	Sektori privat	44%	27%	37%
I/E papunë		42%	26%	33%
Student		50%	22%	30%
Pensionist		36%	24%	33%
Niveli i të ardhurave				
Pa të ardhura		44%	25%	32%
Deri në 40,000 lekë		40%	23%	33%
40,001–60,000 lekë		48%	32%	43%
60,001–80,000 lekë		51%	34%	45%
Mbi 80,001 lekë		53%	26%	38%
Vendbanimi				
Urban		45%	29%	38%
Rural		45%	24%	34%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve


Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 15: Ndarja demografike e proceseve të konsultimeve në 2022—Vetëm përgjigjet e kategorisë “Po” (2023)

	Ftesa për të marrë pjesë në konsultime në 2023		Pjesëmarrja faktike në konsultime në 2023		Përdorimi i platformës konsultimipublik.gov.al	
	Në nivel qendror	Në nivel vendor	Në nivel qendror	Në nivel vendor		
Total	11%	19%	10%	15%	14%	
Gjinia						
Gra	12%	19%	10%	16%	14%	
Burra	10%	19%	9%	15%	14%	
Mosha						
18–25 vjeç	11%	17%	10%	15%	19%	
26–35 vjeç	14%	22%	13%	18%	18%	
36–45 vjeç	13%	22%	12%	19%	18%	
46–55 vjeç	10%	20%	8%	16%	12%	
56–65 vjeç	7%	13%	6%	9%	6%	
66 vjeç e sipër	2%	8%	3%	5%	5%	
Niveli Arsimor						
Me arsim deri 8/9-vjeçar	9%	15%	7%	11%	9%	
Me arsim të mesëm	9%	18%	8%	14%	13%	
Me arsim universitar	14%	21%	13%	19%	18%	
Statusi i Punësimit						
I/E punësuar	Gjithsej	13%	20%	11%	17%	15%
	Sektori publik	18%	30%	17%	25%	23%
	Sektori privat	10%	17%	9%	14%	12%
I/E papunë	9%	17%	9%	14%	13%	
Student	10%	17%	8%	13%	21%	
Pensionist	7%	14%	8%	12%	10%	
Niveli i të ardhurave						
Pa të ardhura	9%	16%	9%	14%	14%	
Deri në 40,000 lekë	8%	17%	6%	12%	12%	
40,001–60,000 lekë	15%	23%	12%	19%	14%	
60,001–80,000 lekë	19%	25%	17%	22%	23%	
Mbi 80,001 lekë	13%	17%	11%	14%	15%	
Vendbanimi						
Urban	11%	19%	10%	16%	15%	
Rural	10%	18%	8%	15%	12%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar)..



8. OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Që nga viti 2013, sondazhi i opinionit publik ka matur në një kapitull të veçantë kënaqshmërinë e qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike. Numri i shërbimeve ka ndryshuar me kalimin e viteve, përfshirë shërbimet e shëndetit publik, shërbimet e arsimit publik (përfshirë edhe arsimin parashkollor), furnizimi me ujë të pijshëm, transporti publik, shërbimet e pastrimit (të qytetit, fshatit përfshirë edhe mbledhjen e mbetjeve), shërbimet e emergjencave (zjarrfikësja, ambulanca etj.), shërbimet gjyqësore, shërbimet e policisë. Që nga edicioni i vitit 2021, për të vlerësuar më mirë kënaqshmërinë me shërbimet e emergjencave, ato u ndanë në "Shërbimet e emergjencave: ambulanca" dhe "Shërbimet e emergjencave: zjarrfikësi", duke bërë të mundur një vlerësim të veçantë për të dy.

Në shërbimet administrative bëjnë pjesë shërbimet e ndihmës sociale, shërbimet e punësimit (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive – ish Shërbimi Kombëtar i Punësimit SHKP), shërbimet e kadastrës (Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK: ish-Hipoteka dhe ALUIZNI), shërbimet e gjendjes civile, shërbimet e sigurimeve shoqërore (Instituti i Sigurimeve Shoqërore ISSH), shërbimet e transportit rrugor (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor DPSHTRR), regjistrimi dhe licencimi i biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit QKB), lejet e ndërtimit.

Pyetjet e tjera u fokusuan në kritikën e të anketuarve për shërbimin e ofruar, kanalet për të bërë ankesa (si në platformën e bashkëqeverisjes www.shqiperiaqeduam.al) dhe përgjigja nga ofruesit e shërbimeve publike.

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE BAZË

Në vitin 2023, si mesatare, 39.3% e të anketuarve thanë se ishin "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" me ofrimin e shërbimeve publike bazë. Duhet thënë se kënaqshmëria më e lartë është me shërbimin e furnizimit me ujë, me 47.2% që raportojnë se janë të kënaqur. Sistemi arsimor, përfshirë edhe atë parashkollor, e ndjek me 46.2% që thonë se janë 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur'. Po ashtu, rreth 44% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me shërbimet e ofruara nga sistemi i kujdesit shëndetësor.


Në vitin 2023, mesatarisht, rreth katër nga dhjetë (39.3%) ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me ofrimin e shërbimeve publike bazë.⁷

Ashtu si një vit më parë, tre shërbimet publike bazë për të cilat qytetarët shprehën nivelin më të lartë të kënaqshmërisë ishin furnizimi me ujë, arsimit dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Shërbimi i furnizimit me ujë ka marrë vlerësimet më të larta të kënaqshmërisë, me 47.2% të të anketuarve që u shprehën të kënaqur; ndjekur nga afër nga sistemi arsimor (përfshirë arsimin parashkollor), ku 46.2% ishin 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur'. Ndërkohë rreth 44% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me shërbimet e ofruara nga sistemi i kujdesit shëndetësor.

Nga ana tjetër, shërbimet gjyqësore evidentohen si më pak të kënaqshme për qytetarët, me vetëm 25.5% që deklarojnë se janë 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur'.

7 Mesatarja e vlerësimit të kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet publike bazë të marra së bashku.

Figura 47. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2023

Baza: N = 2500 për të gjitha shërbimet


KRAHASIMI DEMOGRAFIK PËR KËNAQSHMËRINË ME SHËRBIMET PUBLIKE BAZË

Analiza demografike për ofrimin e shërbimeve publike bazë mbështetet në nivelet e kënaqshmërisë së raportuara nga të gjithë pjesëmarrësit e këtij sondazhi. Ndonëse të dhënat sipas ndarjes gjinore treguan se nuk kishte dallime të mëdha për sa i përket kënaqshmërisë, rezultatet e ndara sipas grupmoshës nxorën në pah se qytetarët në moshë të re priren të jenë më pak të kënaqur se sa ata në moshë më të madhe. Kjo tendencë vëhet re në edhe kur analizojmë të anketuarit sipas nivelit arsimor, ku ata me diplomë universitare ose pasuniversitare shprehen përgjithësisht shumë të kënaqur me shërbimet publike në krahasim me të anketuarit me nivel më të ulët arsimor.

Një tjetër dallim i dukshëm vëhet re tek punonjësit e sektorit publik, të cilët priren të jenë më të kënaqur me shërbimet publike në krahasim me ata të punësuar në sektorin privat. Për më tepër, të dhënat e kategorizuara sipas niveleve të të ardhurave tregojnë se të anketuarit me të ardhura më të larta mujore priren të jenë shumë të kënaqur me shërbimet publike bazë në krahasim me ata me të ardhura të pakta mujore. Referojuni Tabelës 18 për të dhëna më të hollësishme sipas ndarjeve demografike.

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE BAZË NË VITE

Mesatarisht, më pak se gjysma e të anketuarve gjatë periudhës 2016-2023 janë shprehur të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë. Gjatë viteve të fundit (2019-2023), niveli i kënaqshmërisë ka qëndruar në intervalin 38-42%. Më konkretisht, rezultatet për vitin 2023 tregojnë se 39% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me këto shërbime.

Figura 48. Përqindja e të gjithë të anketuarve "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" me shërbimet publike bazë (2016-2023)

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE ADMINISTRATIVE

58.5% e përdoruesve të shërbimeve administrative raportojnë se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur. Gjithsesi, kjo përqindje bie në 36.4% kur marrin parasysh të gjithë të anketuarit, pavarësisht nëse kanë përdorur shërbime të tilla në vitin 2023 apo jo.

Kur shqyrtojmë shërbimet administrative, analiza ndahet mes qytetarëve në përgjithësi dhe atyre që kanë raportuar se i përdorin këto shërbime në vitin 2023. 58.5% e përdoruesve të shërbimeve administrative ishin të 'kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me këto shërbime. Përqindja është më e ulët, 36.4%, kur marrin parasysh të gjithë të anketuarit, pavarësisht nëse kanë përdorur shërbime të tilla në vitin 2023 apo jo.

Të dhënat e detajuara tregojnë se 43% e të gjithë të anketuarve ishin të 'kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me shërbimet e sigurimeve shoqërore dhe 44,2% me shërbimet e transportit rrugor. Nga ana tjetër, vetëm 27.5% ishin 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me shërbimet e kadastrës dhe 25.9% me lejet e ndërtimit.

Figura 49. Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative 2023 (të gjithë të anketuarit)



Baza: N = 2500 për të gjitha shërbimet e listuara

Duke shqyrtuar vetëm ata të anketuar që i kanë përdorur faktikisht këto shërbime, vihet re një rritje e konsiderueshme e niveleve të kënaqshmërisë. Për shembull, 57.3% e përdoruesve të shërbimeve të asistencës sociale u shprehën 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur'. Po kështu, 47.4% e përdoruesve të shërbimit të punësimit thanë se ishin të kënaqur me këtë shërbim.

Në Tabelën 16 jepen koeficientët e përdorimit për çdo shërbim. Është evidente se shërbimi më i përdorur nga qytetarët në vitin 2023 ka qenë shërbimi i gjendjes civile, të cilin e kanë përdorur 54.4% e të anketuarve. Nga ana tjetër, shërbimi më pak i përdorur është ai i lejeve të ndërtimit, të cilin e kanë përdorur vetëm 5.9% e qytetarëve.

Tabela 16: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative (2023)

	Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë 2023	% e të anketuarve që përdorën shërbimin në in 2023	Niveli i kënaqshmërisë mes atyre që kishin përdorur shërbimin në 2023
Shërbimet e asistencës sociale	34%	23.3%	57.3%
Shërbimet e punësimit	30%	25.5%	47.4%
Shërbimet e pronësisë	28%	33.9%	38%

	Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë 2023	% e të anketuarve që përdorën shërbimin në in 2023	Niveli i kënaqshmërisë mes atyre që kishin përdorur shërbimin në 2023
Shërbimet e gjendjes civile	56%	54.4%	71.6%
Shërbimet e sigurimeve shoqërore	43%	35.2%	66.7%
Shërbimet e transportit rrugor	43%	33.7%	68.3%
Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	31%	13.9%	68.6%
Lejet e ndërtimit	26%	5.9%	50.4%

KRAHASIMI DEMOGRAFIK PËR KËNAQSHMËRINË ME SHËRBIMET ADMINISTRATIVE PËR PËRDORUESIT

Analiza demografike për shërbimet administrative fokusohet ekskluzivisht tek përdoruesit e këtyre shërbimeve në vitin 2023. Të dhënat sipas ndarjes gjinore nxjerrin në pah nivele të krahasueshme kënaqshmërie mes grave dhe burrave.


Individët me nivele më të ulëta arsimore u shprehën më pak të kënaqur, ndërsa ata me nivele më të larta arsimore raportojnë se janë më të kënaqur. Ashtu si me gjetjet e shërbimeve publike bazë, të punësuarit e sektorit publik treguan nivele më të mëdha kënaqshmërie me shërbimet administrative krahasuar me të anketuarit e punësuar në sektorin privat. Në përgjithësi, të anketuarit që banojnë në zonat rurale shfaqën një nivel më të lartë të kënaqësisë me shërbimet administrative. Megjithatë, vlen të përmendet se kur marrim parasysh në mënyrë të veçantë lejet e ndërtimit, të anketuarit që banojnë në zonat urbane tregojnë një nivel më të lartë kënaqësie me këtë shërbim të veçantë.

Lutemi referojuni Tabelës 20 për një ndarje më të hollësishme demografike të këtyre rezultateve.

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE ADMINISTRATIVE: PËRDORUESIT E SHËRBIMEVE DHE TË GJITHË TË ANKETUARIT NË VITE

Përdoruesit e shërbimeve publike administrative kanë raportuar vazhdimisht shifra dukshëm më të larta kënaqshmërie krahasuar me nivelin e përgjithshëm të kënaqshmërisë të raportuar nga të gjithë të anketuarit nga viti 2019 deri në vitin 2023. Ky trend pozitiv ka vazhduar, duke kulmuar me një shkallë kënaqshmërie prej 59% në 2023.

Figura 50. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative: përdoruesit e shërbimeve dhe të gjithë të anketuarit (2019–2023)




*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

PARAQITJA E ANKESAVE

Në vitin 2023, 14.7% e të anketuarve raportuan se kanë bërë një ankesë për një shërbim publik. Këtu kemi një rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë, ku 13.4% e të anketuarve thanë se kanë bërë ankesë.

Figura 51. Përqindja e të anketuarve që kishin bërë ankesë tek institucionet (2016–2023)



Baza: 2016 (N = 1627); 2017 (N = 1639); 2018 (N = 1628); 2019 (N = 2491); 2020 (N = 2488); 2021 (N = 2494); 2022 (N=2491); 2023 (N=2481).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.


Përqindja e grave (13.6%) dhe burrave (15.8%) që kanë raportuar se kanë bërë ankesa nuk ka dallime të mëdha. Megjithatë, të anketuarit e moshës 18-25 vjeç (18.6%) dhe studentët (18.8%) kishin më shumë gjasa se të anketuarit në grupet e tjera demografike të raportonin se kishin bërë një ankesë në lidhje me një shërbim të marrë nga një ofrues i shërbimit publik në vitin 2023.

PLATFORMA E BASHKËQEVERISJES SHQIPERIAQEDUAM.AL


Në vitin 2023, 20.9% e qytetarëve shqiptarë përdorën platformën online të bashkëqeverisjes 'www.shqiperiaqeduam.al' për të bërë një ankesë. Ndër ata të anketuar që kanë bërë një ankesë nëpërmjet kësaj platforme, 30.3% kanë raportuar se shqetësimet e tyre janë trajtuar.

Në krahasim me shifrat e vitit 2022 (9.5%), ka pasur një rritje të konsiderueshme në përqindjen e qytetarëve që kanë përdorur këtë platformë për të bërë një ankesë në vitin 2023.

Figura 52. A keni bërë ndonjë ankesë tek platforma e bashkëqeverisjes 'www.shqiperiaqeduam.al' në vitin 2023?



Baza: N=2500

Figura 53. Nëse keni bërë ankesë te 'shqiperiaqeduam.al', a është zgjidhur ajo? (2023)

Baza: N=511


Kur shqyrtojmë të dhënat sipas gjinisë, shohim se nuk ka dallime të mëdha mes grave (20.8%) dhe burrave (21.2%) për sa i përket paraqitjes së ankesave përmes platformës. Megjithatë, të anketuarit e moshës 18-25 vjeç (24.5%) dhe studentët (28.3%) ishin shumë herë më të prirur të përdornin platformën shqiperiaqeduam.al për të bërë ankesa në krahasim me të anketuarit e grupeve të tjera demografike.

DIJENIA DHE PËRDORIMI I PORTALIT E- ALBANIA

Shumica dërrmuese e shqiptarëve (92%) janë në dijeni të shërbimeve elektronike që ofrohen nga qeveria. Mes atyre që kanë përdorur portalin e-Albania, 45.4% raportojnë se e përdorin atë vazhdueshëm pa ndihmën e të tjerëve. Shumica, e përbërë nga 84.7%, i konsiderojnë këto shërbime funksionale dhe 59.7% besojnë se ato u japin mundësi qytetarëve për të kërkuar ndihmën e nevojshme. Po ashtu, 57.3% e konsiderojnë platformën të lehtë për t'u përdorur. Megjithatë, niveli më i ulët i kënaqësisë ka qenë kur vjen fjala për mundësinë që qytetarët të japin mendime apo sugjerime, ku vetëm 46.1% shprehen se janë shprehur të kënaqur në këtë drejtim.

Në këtë pjesë analizohen disa aspekte me fokus përdorimin e portalit e-Albania për marrjen e shërbimeve elektronike dhe vlerësimin e këndvështrimeve të publikut për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave. Nëpërmjet këtij informacioni merren këndvështrime të vlefshme për ndërgjegjësimin dhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me ruajtjen e informacionit personal, duke luajtur kështu një rol vendimtar në hartimin e politikave rreth sigurisë së të dhënave.

Më konkretisht, të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e shqiptarëve, 92%, janë në dijeni për shërbimet elektronike që ofrohen nga qeveria.


Figura 54. Dijenia për shërbimet elektronike nëpërmjet portalit e-albania.al

Baza: N=2500

Të rinjtë e intervistuar (18-25 vjeç) shfaqin një nivel më të lartë njohurie, me 95.6%, krahasuar me ata të moshës 66 vjeç e lart, ku niveli i dijenisë për këtë portal është 77.8%. Për më tepër, niveli arsimor duket të jetë një faktor kontribuues në informimin për shërbimet publike të ofruara nga e-Albania. Të anketuarit me nivel më të ulët arsimor ishin më pak të informuar në krahasim me ata me një nivel arsimor universitar ose pasuniversitar. Nga ana tjetër, të anketuarit nga zonat urbane kishin një nivel të ngjashëm njohurie në krahasim me ata që banojnë në zonat rurale.

Për më tepër, 75.6% e atyre që janë në dijeni të platformë e-Albania thonë që e kanë përdorur atë gjatë vitit 2023.

Figura 55. A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania?



Baza: N=2284

Gratë dhe burrat përdornin shërbimet elektronike pothuajse në të njëjtin nivel. Megjithatë, të anketuarit më të rinj, individët me nivel universitar ose pasuniversitar dhe ata që jetojnë në zonat urbane ishin më të prirur për të marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.

Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve që përdorën portalin e-Albania për të marrë shërbime elektronike raportuan se e përdornin atë vetë pa asnjë ndihmë, duke përbërë kështu 45.4% të të anketuarve. Po ashtu, 22.2% thanë se rrallë kanë marrë ndihmë nga të tjerët, ndërsa 18.8% kanë deklaruar se zakonisht kërkojnë ndihmë nga të tjerët. Së fundi, 13.6% treguan se ata gjithmonë mbështeten në ndihmën e të tjerëve sepse nuk janë në gjendje ta përdorin portalin pa ndihmën e të tjerëve.

Tabela 17: Marrja shërbimeve nga portali e-Albania (2023)


	N	%
Gjithmonë vetë	787	45.4%
Zakonisht vetë (rrallëherë me ndihmën e dikujt tjetër)	385	22.2%
Zakonisht me ndihmë nga dikush tjetër (rrallëherë i marr vetë)	325	18.8%
Gjithmonë me ndihmë nga dikush tjetër	235	13.6%
Total	1.732	100%

Rezultatet sipas ndarjes demografike tregojnë se 75.2% e të anketuarve të moshës 18-25 vjeç e kanë përdorur vazhdimisht platformën pa ndihmën e të tjerëve. Si për kontrast, vetëm 9.3% e të anketuarve të moshës 66 vjeç e lart kanë arritur ta përdorin atë gjithmonë vetë. Shumica e popullsisë në moshë të thyer, 51.5%, mbështetej në ndihmën e të tjerëve. Kjo mospërputhje eidenton aftësitë u shumta teknologjike të popullsisë së re në moshë në krahasim me grupmoshat e tjera.

Vihen re variacione të tjera nëse marrim për bazë nivelin arsimor dhe vendbanimin, ku të anketuarit me nivel të lartë arsimor dhe ata që jetojnë në zona urbane kishin më shumë aftësi për të përdorur platformën vetë pa ndihmën e të tjerëve.

Po ashtu, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin aspekte të ndryshme të shërbimeve që ofroheshin nëpërmjet portalit e-Albania. Pjesa më e madhe, me 84.7%, i konsideronte këto shërbime si funksionale. 59.7% besonin se këto shërbime i japin mundësi qytetarëve për të kërkuar ndihmën që iu nevojitet. 57.3% e konsiderojnë platformën të thjeshtë për t'u përdorur. Gjithsesi, aspekti që ka marrë vlerësimin më të ulët ka të bëjë me mundësinë për të dhënë komente apo sugjerime përmes platformës, ku vetëm 46.1% janë shprehur të kënaqur në këtë drejtim.

Figura 56. Vlerësimi i shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (2023)




Baza: N1=1839; N2=1821; N3=1816; N4=1681.

Funksionaliteti pranohet në mënyrë uniforme nga të gjithë të anketuarit, pavarësisht ndarjeve demografike. Gjithsesi, perceptimi i thjeshtësisë së përdorimit të platformës është i ndryshëm sipas grupmoshave. Rreth tetë nga dhjetë të anketuar të rinj në moshë e perceptuan platformën si të thjeshtë për t'u përdorur, ndërkohë që vetëm tre nga dhjetë të anketuar të moshës mbi 56 vjeç kanë të njëjtin mendim. Për më tepër, të anketuarit me nivel më të ulët arsimor prireshin të jepnin një vlerësim më pak të favorshëm për sa i përket thjeshtësisë së përdorimit të kësaj platforme krahasuar me ata me arsim universitar ose pasuniversitar.


MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Rezultatet tregojnë se mbrojtja e të dhënave personale është e një rëndësie të madhe për shqiptarët. 90.7% e pjesëmarrësve në këtë sondazh e konsiderojnë mbrojtjen e të dhënave personale si të rëndësishme ose shumë të rëndësishme.

Figura 57. Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave personale për qytetarët (2023)

Baza: N=2447

Qytetarët treguan pothuajse të njëjtin nivel besimi të aktorët publikë dhe sektori privat kur bëhet fjalë për trajtimin e të dhënave të tyre personale elektronike, ku 35% e të anketuarve u shprehën se kanë besim tek aktorët publikë dhe 31% tek sektori privat. Megjithatë, shumica, e përbërë nga më shumë se gjashtë në dhjetë individë, në thelb nuk kanë besim ose nuk kanë aspak besim as te institucionet publike dhe as tek ato private.

Figura 58. Niveli i besimit në miradministrimin e të dhënave personale elektronike/ digjitale nga aktorët publikë përkundër sektorit privat (2023)

Baza: N=2492 për institucionet publike; N=2479 për institucionet private

Tabela 18: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë sipas grupeve demografike (2023)

	Shërbimet publike (të gjithë të anketuarit)									
	Shëndetësia	Arsimi	Furnizimi me ujë	Transporti publik	Pastrimi	Emergjencia: ambulanca	Emergjencia: zjarrfikësi	Gjyqësori	Policia	
Gjithsej (% e kënaqshmërisë)	44%	46%	47%	32%	47%	39%	37%	26%	35%	
Gjinia										
Gra	44%	47%	47%	32%	48%	39%	37%	26%	36%	
Burra	44%	45%	48%	32%	46%	40%	38%	25%	35%	
Mosha										
18–25 vjeç	39%	35%	40%	30%	40%	32%	30%	23%	32%	
26–35 vjeç	45%	48%	48%	34%	50%	43%	42%	27%	36%	
36–45 vjeç	48%	52%	50%	32%	47%	40%	36%	26%	37%	
46–55 vjeç	43%	51%	49%	32%	48%	38%	37%	24%	34%	
56–65 vjeç	40%	40%	45%	29%	47%	40%	41%	26%	36%	
66 vjeç e sipër	47%	45%	49%	32%	53%	41%	32%	24%	37%	
Niveli arsimor										
Me arsim deri 8/9-vjeçar	41%	44%	42%	28%	45%	37%	37%	26%	34%	
Me arsim të mesëm	43%	46%	45%	30%	46%	36%	34%	24%	34%	
Me arsim universitar	47%	48%	52%	36%	50%	44%	41%	28%	39%	
Statusi i Punësimit										
I/E punësuar	Gjithsej	48%	51%	51%	35%	50%	43%	40%	26%	38%
	Sektori publik	58%	58%	58%	43%	57%	50%	41%	32%	43%
	Sektori privat	42%	44%	46%	30%	45%	36%	36%	24%	33%
I/E papunë	39%	42%	40%	28%	41%	34%	34%	25%	33%	
Student	36%	33%	41%	33%	40%	31%	30%	22%	32%	
Pensionist	42%	45%	48%	27%	49%	38%	36%	25%	34%	
Niveli i të ardhurave										
Pa të ardhura	38%	42%	40%	28%	44%	34%	35%	26%	33%	
Deri në 40,000 lekë	46%	47%	46%	30%	47%	41%	40%	26%	37%	
40,001–60,000 lekë	46%	52%	51%	37%	49%	40%	40%	28%	38%	
60,001–80,000 lekë	49%	49%	55%	34%	48%	41%	35%	25%	34%	
Mbi 80,001 lekë	47%	50%	53%	30%	51%	43%	39%	25%	36%	
Vendbanimi										
Urban	43%	46%	47%	31%	48%	39%	36%	26%	35%	
Rural	46%	46%	49%	34%	44%	40%	40%	25%	36%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 19: Ndarja demografike e nivelit të kënaqshmërisë së të gjithë të anketuarve të shërbimeve administrative 2023

(Vetëm përqindja e të anketuarve që deklaruan se janë “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur”,

Shërbimet administrative (vetëm përdoruesit)									
	Asistenca sociale	Punësimi	Pronat	Gjendja civile	Sigurimet Shoqërore	Transporti rrugor	Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	Lejet e ndërtimeve	
Gjithsej (% e kënaqshmërisë)	34%	30%	28%	56%	43%	43%	31%	26%	
Gjinia									
Gra	34%	30%	26%	56%	41%	41%	30%	26%	
Burra	34%	31%	29%	56%	45%	45%	32%	26%	
Mosha									
18–25 vjeç	29%	27%	23%	44%	37%	40%	25%	21%	
26–35 vjeç	34%	32%	30%	59%	46%	51%	35%	27%	
36–45 vjeç	37%	34%	30%	58%	41%	44%	31%	27%	
46–55 vjeç	34%	31%	28%	59%	41%	40%	30%	27%	
56–65 vjeç	34%	26%	24%	51%	43%	38%	32%	26%	
66 vjeç e sipër	37%	28%	23%	60%	51%	35%	28%	22%	
Niveli Arsimit									
Me arsim deri 8/9-vjeçar	34%	26%	24%	51%	39%	38%	29%	24%	
Me arsim të mesëm	33%	30%	27%	56%	44%	41%	29%	25%	
Me arsim universitar	36%	33%	30%	59%	45%	47%	33%	28%	
Statusi i Punësimit									
I/E punësuar	Gjithsej	36%	33%	30%	59%	44%	46%	32%	27%
	Spektori publik	43%	41%	38%	66%	50%	51%	40%	35%
	Spektori privat	31%	27%	25%	53%	40%	40%	28%	22%
I/E papunë	31%	25%	25%	49%	41%	37%	29%	25%	
Student	29%	29%	26%	46%	38%	41%	28%	23%	
Pensionist	31%	27%	22%	55%	41%	33%	27%	23%	
Niveli i të ardhurave									
Pa të ardhura	31%	28%	27%	48%	42%	38%	30%	25%	
Deri në 40,000 lekë	34%	28%	27%	56%	42%	41%	30%	27%	
40,001–60,000 lekë	38%	34%	30%	60%	44%	48%	32%	29%	
60,001–80,000 lekë	35%	37%	33%	57%	43%	46%	34%	26%	
Mbi 80,001 lekë	30%	32%	27%	59%	48%	47%	40%	28%	
Vendbanimi									
Urban	32%	30%	27%	54%	42%	42%	29%	25%	
Rural	41%	32%	30%	61%	47%	44%	37%	29%	



Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve**Shënim:** Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 20. Ndarja demografike e nivelit të kënaqshmërisë vetëm të përdoruesve të shërbimeve administrative 2023
(Vetëm përqindje e përdoruesve që thanë se janë “të kënaqur” ose “shumë kënaqur”)

Shërbimet administrative (vetëm përdoruesit)								
	Asistenca sociale	Punësimi	Pronat	Gjendja civile	Sigurimet Shogërore	Transporti rrugor	Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	Lejet e ndërtime
Gjithsej (% e kënaqshmërisë)	57%	47%	38%	72%	67%	68%	69%	50%
Gjinia								
Gra	59%	51%	38%	73%	65%	70%	66%	47%
Burra	56%	44%	37%	70%	68%	67%	71%	54%
Mosha								
18–25 vjeç	63%	45%	39%	68%	74%	68%	65%	66%
26–35 vjeç	64%	46%	46%	73%	72%	72%	67%	55%
36–45 vjeç	63%	52%	41%	72%	64%	67%	70%	52%
46–55 vjeç	50%	53%	38%	75%	67%	72%	70%	43%
56–65 vjeç	44%	38%	25%	63%	62%	59%	67%	48%
66 vjeç e sipër	55%	40%	26%	78%	64%	63%	83%	18%
Niveli Arsimit								
Me arsim deri 8/9-vjeçar	53%	41%	29%	63%	61%	63%	64%	37%
Me arsim të mesëm	51%	43%	37%	70%	68%	68%	71%	49%
Me arsim universitar	67%	54%	44%	78%	69%	72%	68%	59%
Statusi i Punësimit								
I/E punësuar	Gjithsej	66%	52%	41%	74%	70%	71%	55%
	Spektori publik	69%	64%	53%	83%	76%	81%	69%
	Spektori privat	54%	43%	35%	69%	64%	65%	46%
I/E papunë	42%	39%	36%	65%	65%	61%	61%	48%
Student	53%	45%	47%	67%	73%	66%	65%	50%
Pensionist	61%	45%	27%	69%	58%	61%	67%	37%
Niveli i të ardhurave								
Pa të ardhura	43%	41%	39%	66%	67%	61%	63%	48%
Deri në 40,000 lekë	61%	43%	35%	68%	60%	67%	71%	52%
40,001–60,000 lekë	68%	48%	40%	72%	70%	72%	65%	52%
60,001–80,000 lekë	66%	59%	49%	76%	68%	73%	79%	54%
Mbi 80,001 lekë	33%	56%	39%	80%	73%	73%	76%	48%
Vendbanimi								
Urban	53%	46%	38%	70%	64%	68%	67%	53%
Rural	67%	52%	39%	75%	73%	70%	72%	46%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).



9. NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKE

Për forcimin dhe konsolidimin e transparencës, llogaridhënies dhe vlerave demokratike që përfaqësojnë ato, është me rëndësi jetike të kuptohet dhe vlerësohet ndikimi politik në institucionet publike. Kështu sigurohet që vendimet bazohen në merita dhe jo në programe politike, duke ruajtur kështu besimin e publikut, duke nxitur stabilitetin afatgjatë dhe duke parandaluar korrupsionin ose abuzimin me pushtetin. Vlerësimi i këtij ndikimi ka rëndësi për ruajtjen e integritetit dhe qëllimit të këtyre institucioneve brenda një kuadri demokratik. Si pjesë e këtij sondazhi, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin sipas mendimit të tyre, sa ndikojnë interesat politike në axhendën e dhjetë institucioneve –prokuroria, gjykatat, policia, forcat e armatosura, institucionet e shëndetit publik, institucionet arsimore, media, institucionet fetare, organizatat e shoqërisë civile dhe SPAK– në një shkallë prej pesë pikësh nga 1 (nuk ndikon aspak) në 5 (ndikon jashtëzakonisht shumë).


INTERESAT POLITIKE NË AXHENDËN E INSTITUCIONEVE NË VITIN 2023

Gjykatat dhe prokuroria u perceptuan si institucionet më të ndikuara politikisht me 35.5% dhe 35.3% të të anketuarve që i vlerësojnë ato si të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga interesat politike. Nga ana tjetër, institucionet fetare konsiderohen si institucionet më pak të ndikuara politikisht, me vetëm 7.9% të të anketuarve që i perceptojnë ato si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara dhe një shumicë dërrmuese prej 70.4% që i perceptojnë institucionet fetare si pak ose aspak të ndikuara.

Të dhënat nxorën në pah variacione të mëdha për ndikimin e perceptuar politik tek institucione të ndryshme. Policia u rendit e treta, ashti si me gjykatat dhe prokurorinë për sa i përket perceptimit ndikimin nga interesat politike. 32.5% e të anketuarve besojnë se policia ndikohet shumë ose jashtëzakonisht shumë nga interesat politike. Sa i përket më pak të ndikuarve, institucionet fetare pasoheshin nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat vetëm 13.1% e të anketuarve i perceptuan se ndikohen shumë ose jashtëzakonisht shumë dhe 55% i konsiderojnë ato se ndikohen pak ose aspak nga interesat politike. Forcat e armatosura u vlerësuan si “të pa ndikuar” ose “pak të ndikuar” nga 46.2% e të anketuarve, ndjekur nga SPAK (44.9%), institucionet arsimore publike (41.4%) dhe institucionet shëndetësore publike (40.6%). Media është perceptuar si ‘pak e ndikuar’ ose ‘aspak e ndikuar’ nga 37.4% e të anketuarve.

Vlen të përmendet se për të gjitha institucionet e listuara është përzgjedhur relativisht shpesh edhe përgjigja neutrale.

Figura 59. Perceptimi për ndikimin politik në programin e institucioneve (2023)



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet e listuara.

KRAHASIMI DEMOGRAFIK PËR PERCEPTIMIN E NDIKIMIT POLITIK

Si gratë ashtu edhe burrat kishin perceptime të ngjashme për sa i përket ndikimit politik për institucionet e listuara në pyetësor. Kur analizojmë përgjigjet sipas grupmoshës së të anketuarve, të anketuarit më të vjetër në moshë prireshin më pak t'i perceptonin prokurorinë, gjykatat, policinë, institucionet publike shëndetësore dhe SPAK-un se ndikohen shumë ose jashtëzakonisht shumë nga interesat politike. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç ishin më shumë të prirur të perceptonin prokurorinë (40%), institucionet publike shëndetësore (32%) dhe institucionet arsimore (34%) dhe SPAK (33%) të ndikuara nga interesat e partive politike. Nga ana tjetër, të anketuarit e moshës 66 vjeç e lart kishin më pak gjasa t'i konsideronin të gjitha institucionet, përveç policisë, si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga interesat politike.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve sipas nivelit të arsimit, të anketuarit me nivel më të ulët arsimor kishin perceptime të ngjashme të ndikimit politik tek institucionet në krahasim me ata me diplomë universitare. Punonjësit e sektorit publik ishin më pak të prirur të thoshin se institucionet e listuara ndikoheshin shumë ose jashtëzakonisht shumë nga politika në krahasim me ata që punonin në sektorin privat. Po ashtu, studentët prireshin më shumë gjasa t'i konsideronin të gjitha institucionet e listuara, përveç mediave dhe OSHC-ve, si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga interesat politike.

Për sa i përket të ardhurave, të anketuarit me të ardhura neto prej 800,001 lekë ose më të larta kishin më shumë gjasa t'i perceptonin policinë (38%) dhe institucionet shëndetësore publike (32%) si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuar nga interesat politike në krahasim me grupet e tjera të të ardhurave. Së fundmi, të anketuarit nga zonat rurale kishin më shumë gjasa të raportonin se media ndikohet shumë ose jashtëzakonisht shumë nëse krahasohen me të anketuarit nga zonat urbane. Për më shumë informacione sipas grupeve demografike, shihni Tabelën 22 në fund të këtij kreu.

NDIKIMI POLITIK NË VITE

Në tabelën e mëposhtme tregohen vlerësimet e ndikimit të madh ose jashtëzakonisht të madh nga interesat politike për dhjetë nga institucionet e listuara gjatë viteve 2016-2023.

Gjatë gjithë periudhës, shumë nga institucionet e listuara u perceptuan se ndikohen nga interesa politike, ku gjykatat dhe prokuroria shiheshin vazhdimisht si më të ndikuarat. Megjithatë, ka pasur disa ndryshime të dukshme me kalimin e kohës dhe ndërmjet institucioneve.

Për shembull, përqindja e të anketuarve që i konsideronin gjykatat si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga politika është ulur ndjeshëm nga 61% në 2019 në 36% në 2023. E njëjta gjë vihet re edhe në përqindjen e të anketuarve që e mendonin prokurorinë si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuar, përqindje që është ulur nga 59% në 2019 në 35% në 2023.

Krahasuar me vitin 2022, perceptimi i ndikimit politik të të gjitha institucioneve u përmirësua, ku media (9 p.p.), SPAK (8 p.p.) dhe gjykatat (7 p.p.) patën ndryshimin më të madh pozitiv. Institucionet fetare, OSHC-të dhe forcat e armatosura vazhdojnë të jenë institucionet që kanë më pak gjasa të perceptohen si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuar nga interesat politike.

Tabela 21: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016–2023)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Mesatare
Gjykatat		70%	63%	61%	56%	49%	42%	36%	54%
Prokuroria		67%	60%	59%	58%	48%	39%	35%	52%
Policia	46%	47%	48%	44%	45%	39%	38%	33%	42%
Media	45%	37%	39%	45%	42%	38%	36%	27%	39%
Institucionet e shëndetit publik	41%	34%	36%	33%	37%	32%	30%	27%	34%
Institucionet e arsimit publik	38%	29%	34%	33%	34%	30%	28%	26%	32%
Ushtria	33%	29%	33%	30%	29%	26%	26%	22%	29%
SPAK							32%	24%	28%
Organizatrat e shoqërisë civile	20%	26%	24%	23%	19%	20%	19%	13%	21%
Institucionet fetare	9%	9%	12%	10%	12%	11%	12%	8%	10%

Baza: Në rendin sipas listës: 2016 (N= 1633, 1621, 1621, 1626, 1629, 1628, 1630, 1628); 2017 (N= 1615, 1616, 1611, 1608, 1615, 1613, 1612, 1614, 1615); 2018 (N= 1628, 1631, 1624, 1614, 1626, 1633, 1629, 1628, 1632); 2019 (N=2488); 2020 (N= 2490); 2021 (N=2495, 2495, 2492, 2475, 2490, 2490, 2493, 2492, 2495) 2022 (N=2500 për të gjitha institucionet e listuara); 2023 (N=2500 për të gjitha institucionet e listuara)

* Që nga viti 2017 e më tej, ‘Gjyqësori’ është ndarë në ‘Prokurori’ dhe ‘Gjykata’.

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.


Legjenda: Ngjyrat nga e kuqja e errët në të kuqe të çelët dhe më pas nga e gjelbra e çelët në të gjelbër të errët shfaqin luhatje duke iu referuar shenjës 50% nga vlerat më të ulëta në ato më të larta.

Tabela 22 Ndarja demografike e institucioneve të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht shumë (2023)

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Ushtria	Institucionet e shëndetit publik	Institucionet e arsimit publik	Media	Institucionet fetare	Organizatet e shoqërisë civile	SPAK	
Gjithsej (% e 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë' të ndikuara)	35%	36%	33%	22%	27%	26%	27%	8%	13%	24%	
Gjinia											
Burra	36%	36%	33%	23%	27%	26%	28%	8%	13%	24%	
Gra	35%	35%	32%	22%	28%	27%	27%	8%	13%	25%	
Mosha											
18–25 vjeç	40%	39%	36%	22%	32%	34%	29%	11%	15%	33%	
26–35 vjeç	38%	38%	36%	23%	29%	29%	32%	9%	15%	29%	
36–45 vjeç	38%	37%	32%	24%	26%	24%	28%	7%	11%	24%	
46–55 vjeç	32%	33%	30%	21%	26%	24%	24%	6%	13%	22%	
56–65 vjeç	30%	32%	29%	23%	26%	26%	26%	8%	14%	19%	
66 vjeç e sipër	29%	30%	29%	17%	19%	19%	19%	3%	7%	15%	
Niveli arsimor											
Me arsim deri 8/9-vjeçar	33%	35%	33%	23%	26%	23%	26%	9%	14%	22%	
Me arsim të mesëm	37%	38%	33%	23%	28%	27%	27%	8%	13%	26%	
Me arsim universitar	35%	33%	32%	21%	27%	27%	28%	8%	13%	24%	
Statusi i Punësimit											
I/E punësuar	Gjithsej	34%	33%	31%	21%	26%	25%	27%	7%	12%	22%
	Spektori publik	25%	22%	22%	16%	20%	20%	22%	8%	11%	17%
	Spektori privat	36%	37%	35%	24%	29%	28%	27%	8%	13%	25%
I/E papunë	37%	39%	36%	26%	30%	27%	27%	9%	16%	28%	
Student	42%	43%	39%	27%	34%	39%	28%	13%	17%	37%	
Pensionist	32%	34%	29%	19%	24%	21%	23%	6%	10%	21%	
Niveli i të ardhurave											
Pa të ardhura	36%	39%	34%	23%	30%	29%	27%	9%	15%	28%	
Deri në 40,000 lekë	33%	33%	29%	21%	25%	25%	25%	8%	12%	22%	
40,001–60,000 lekë	33%	32%	31%	21%	27%	27%	27%	8%	12%	22%	
60,001–80,000 lekë	36%	38%	34%	24%	28%	26%	30%	7%	13%	26%	
Mbi 80,001 lekë	33%	39%	38%	24%	32%	29%	26%	9%	14%	27%	
Vendbanimi											
Urban	36%	37%	32%	22%	27%	27%	25%	8%	12%	26%	
Rural	33%	32%	33%	22%	27%	26%	33%	9%	15%	20%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).



10. PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE

Shqipëria ka bërë përparim të madh për sa i përket përfaqësimit të grave në vendimmarrjen politike. Gjithsesi, duhet trajtuar me përpjekje të vazhdueshme sfida e zhdukjes së diskriminimit dhe e sigurimit të përfshirjes gjinore dhe sociale. Në këtë pjesë të sondazhit për përfshirjen gjinore dhe sociale vlerësohen perceptimet e qytetarëve në lidhje me dallimet gjinore në aksesin të shërbimeve publike dhe aftësinë për të mbajtur poste publike. Të anketuarit u pyetën nëse janë trajtuar ndryshe nga institucionet/nëpunësit publikë për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, paaftësisë apo për arsye të tjera.

PERCEPTIMI PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRINË SHQIPTARE


59.4% e popullsisë në Shqipëri janë dakord se ka barazi mes grave dhe burrave, përqindje e ngjashme me atë të sondazhit të vitit 2022. Meshkujt priren të jenë më shumë dakord krahasuar me femrat se ka barazi mes burrave dhe grave.

Pjesëmarrësit e këtij studimi u pyetën për të thënë se sa ishin dakord me tre pohimet për barazinë gjinore në Shqipëri duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh – nga 1 (plotësisht dakord) në 4 (aspak dakord).

Pohimi 1: “Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave.”

61.5% e të anketuarve raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin e mësipërm, përqindje e ngjashme me atë të vitit 2022 (59.04%). Burrat ishin më shumë të prirur se gratë për të qenë dakord me këtë pohim (64.2% me 54.7%).

Figura 60. Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2023)




Baza: N = 2489

Të punësuarit në sektorin publik kishin më shumë gjasa për të qenë dakord me këtë pohim, ndërsa të anketuarit e moshës 18-25 vjeç prireshin më pak në këtë drejtim.

Në figurën e mëposhtme jepen perceptimet të dallimeve sipas gjinive në vite. Të dhënat për vitet 2016-2023 tregojnë se përgjithësisht më shumë se gjysma e popullsisë në Shqipëri ishte dakord se ka barazi mes burrave dhe grave në shoqëri..

Figura 61. Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2016-2023)



Baza: 2016 (N=1636); 2017 (N=1623); 2018 (N=1636); 2019 (N=2487); 2020 (N=2497); 2021 (N=2493); 2022 (N=2500); 2023 (N=2489)

***Shënim:** Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.


AKSESI NË SHËRBIME PUBLIKE

77.6% e të anketuarve besojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses te shërbimet publike, shifër e ngjashme me ato të vitit 2022 (77.6% me 77.1%).

Pohimi 2: "Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike."

Burrat ishin më shumë të prirur se gratë për të qenë dakord me këtë pohim (79.2% me 76%). Të anketuarit ishin, po ashtu, më të prirur për të qenë dakord me këtë pohim nëse punonin në sektorin publik ose të moshës 36-45 vjeç, ndërkohë që të anketuarit e moshës 18-25 ishin më pak të prirur për të qenë dakord me këtë pohim. Për më tepër, të anketuarit me më shumë të ardhura prireshin të ishin dakord me këtë pohim krahasuar me ata me më pak të ardhura.


Figura 62. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2023)



Baza: N=2491

Të dhënat e sondazhit tregojnë se gjatë viteve 2016-2023 shumica e të anketuarve në Shqipëri besojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtën akses në shërbimet publike, pa dallime të mëdha në perceptimet e grave në krahasim me ato të burrave. Në figurën e mëposhtme jepen gjetjet në vite.

Figura 63. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2016-2023)



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1619); 2018 (N=1624); 2019 (N=2487); 2020 (N=2496); 2021(N=2494); 2022 (N=2500); 2023 (N=2491)

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE SIPAS GJINIVE


71.1% e shqiptarëve të anketuar besojnë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave, përqindje paksa më e ulët se në sondazhin e vitit 2022.

Pohimi 3: "Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave."

71.1% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim – përqindje paksa më e ulët se në vitin 2022 (71.1% me 72.4%). Burrat ishin më shumë të prirur se gratë për të qenë dakord me këtë pohim (72% me 70%).


Të anketuarit ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohim nëse ishin të moshës 18-25 vjeç ose në pension. Nga ana tjetër, të anketuarit e punësuar në sektorin publik dhe ata që kishin të ardhura të rregullta prej 40,001–60,000 lekë ishin më pak të prirur ta besonin këtë pohim.

Figura 64. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2023)



Në figurën e mëposhtme jepen dallimet e perceptuara sipas gjinisë në vite. Të njëjtat perceptime për aksesin në shërbimet publike janë të vërteta edhe për rastin e etikës dhe devotshmërisë, ku shumica e shqiptarëve janë dakord me pohimin gjatë viteve 2016-2022, megjithëse jo në të njëjtin model linear.

Figura 65. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2016–2023)



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1614); 2018 (N=1636); 2019 (N=2487); 2020 (N=2492); 2021 (N=2494); 2022 (N=2500); 2023 (N=2492)

*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua në një kampion përfaqësues kombëtar.

DISKRIMINIMI NGA INSTITUCIONET OSE ZYRTARËT PUBLIKË

Në vitin 2023, 14.3% e popullsisë raportoi se ishte trajtuar ndryshe nga një institucion ose nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar ose arsyeje tjetër – përqindje e njëjtë me vitin 2021 (14.3% kundrejt 14.6%). Nga ata që ishin përballur me diskriminim në vitin 2023, shumica mendonin se ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës ose gjinisë së tyre.

Të anketuarit u pyetën nëse ishin trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, paaftësisë apo arsyeve të tjera. Gjithsej 14.3% e të anketuarve mendonin se ishin trajtuar ndryshe në vitin 2023 për shkak të gjinisë së tyre (3.8%), moshës (5.2%), përkatësisë etnike (2.4%), orientimit seksual (0.4%), paaftësisë (1.1%), ose arsye të tjera (1.5%). 85.7% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se nuk ishin trajtuar ndryshe, përqindje e njëjtë me atë të vitit 2022 (85.7% kundrejt 85.4%).

Tabela 23: Diskriminim nga institucioni (2023)

	N	%
Nuk jam trajtuar ndryshe	2126	85.7
Jam trajtuar ndryshe për shkak të:	363	14.3
Gjinia	94	3.8
Mosha	129	5.2
Përkatësisë etnike	59	2.4
Orientimit seksual	11	0.4
Aftësisë së kufizuar	27	1.1
Tjetër*	36	1.5

Baza: N = 2482

* Tjetër: Për shembull, diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, bindjeve politike, origjinës, dhe besimit fetar.

Gratë ishin më shumë të prirura se burrat për të raportuar se ishin trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë fizike apo për arsye të tjera (15.9% me 12.8%). Dallimi ishte më i theksuar për diskriminimin me bazë gjinore: 6.1% e grave dhe 1.5% e burrave raportuan se trajtoheshin ndryshe për shkak të gjinisë.

Për sa i përket diskriminimit në vite, gjetjet nxjerrin në pah se gjatë periudhës 2016-2023 përqindja e shqiptarëve që raportojnë se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të aftësisë fizike, orientimit seksual, etnisë, moshës, gjinisë apo për arsye të tjera nuk ka ndryshuar shumë. Vlerat luhaten në 12-16%.

SHTOJCA 1: KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT (2013–2023)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Gjinia											
Meshkuj	45%	49%	50%	43%	51%	52%	49%	50,5%	50.6%	51.3%	49.3%
Femra	55%	50%	50%	57%	49%	48%	51%	49,4%	49.3%	48.7%	50.4%
Tjetër (shtuar në 2020)								<0,1%	0.1%		0.2%
Grupmosha											
18–25	14%	23%	22%	18%	19%	16%	19%	17,4%	15.2%	13.8%	12.8%
26–35	14%	22%	25%	23%	23%	23%	26%	26,7%	25.4%	23.8%	24.9%
36–45	14%	18%	16%	19%	19%	19%	20%	19,7%	21.9%	20.2%	22.6%
46–55	19%	18%	17%	18%	19%	20%	16%	16,6%	17%	19.2%	17.4%
56–65	20%	10%	11%	13%	11%	13%	12%	12,4%	12.5%	13.6%	13.8%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%	9%	9%	7%	7,2%	8.1%	9.4%	8.5%
Vendbanimi											
Urban			81%	51%	50%	50%	70%	72,8%	70.7%	65.3%	74.2%
Rural			19%	49%	50%	50%	30%	27,2%	29.3%	34.7%	25.8%
Niveli Arsिमor											
Pa arsim + me arsim fillor	1%	1%	3%	6%	5%	7%	4%	4,0%	4.1%	4.6%	4.5%

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Mbaruar shkollën 8/9-vjeçare	14%	15%	12%	19%	17%	23%	18%	18,3%	17.0%	17.3%	16.5%
Mbaruar shkollën e mesme	40%	41%	40%	50%	50%	46%	44%	41,9%	42.9%	40.6%	40.4%
Me diplomë universitare/ më lart	44%	42%	43%	24%	28%	24%	33%	35,3%	35.8%	36.9%	37.9%
Statusi i punësimit											
I/E punësuar	40%	46%	45%	43%	46%	46%	54%	57,3%	56.8%	57.3%	56.5%
I/E papunë	20%	25%	28%	35%	34%	32%	25%	23,8%	20.6%	19.8%	20.6%
Student	8%	10%	9%	8%	7%	6%	7%	6,5%	7%	6.4%	5.8%
Pensionist	26%	9%	11%	12%	12%	12%	11%	10,9%	11.5%	12.4%	11.2%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%	4%	3%	0,4%	3.2%	3.2%	4.4%
Sektori i punësimit											
Sektori publik				32%	29%	28%	25%	27,7%	27.7%	17.5%	16.6%
Sektori privat				64%	71%	69%	72%	70,4%	68.9%	42.9%	67.6%
Tjetër				4%		3%	3%	2,0%	3.5%	3.6%	15.8%
Të ardhurat e rregullta mujore individuale (Neto)											
Nuk kam të ardhura			34%	33%	37%	32%	29%	28,1%	24.7%	20.8%	24.6%
Deri në 40,000 lekë			21%	25%	24%	28%	25%	19,0%	27.4%	23.8%	26.3%
40,001–60,000 lekë			29%	28%	25%	28%	28%	31,6%	25.7%	27.0%	20.1%
60,001–80,000 lekë			6%	4%	5%	4%	7%	12,0%	13.9%	15.9%	12.7%

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Mbi 80,001 lekë			2%	1%	2%	<1%	2%	2,5%	2.5%	4.5%	5.4%
A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?											
Po					9%	7%	6%	4,4%	5.8%	5.7%	3.6%
Greke					3.20%	2.70%	1.50%	1,1%	1.4%	0.8%	0.4%
Maqedonase					1.60%	1.10%	0.90%	0,6%	0.8%	0.5%	0.2%
Arumune					<0.1%	0.20%	0.20%	<0,1%	0.1%	0.3%	0.0%
Rome					2.30%	2.40%	1.50%	1,1%	1.7%	1.7%	1.6%
Egjiptiane					0.90%	0.20%	0.90%	0,4%	0.8%	1.1%	0.3%
Malazeze					0%	0%	0.10%	0,1%	0.1%	0.2%	0.1%
Boshnjake					0.20%	<0.1%	0.20%	0,2%	0.1%	0.1%	0.0%
Serbe					0%	0%	<0.1%	<0,1%	0.0%	0.0%	0.0%
Bullgare					<0.1%	0.10%	0.30%	0,1%	<0.1%	0.3%	0.1%
Jo					90%	92%	93%	93,5%	92.8%	91.4%	92.9%
A jeni simpatizant i ndonjë partie politike?											
Po					40%	36%	35%	33,6%	40.6%	35.2%	27.6%
PS					15.5%	16.1%	12.3%	11,9%	13.60%	13.4%	17.0%
PD					8.50%	9.20%	8.10%	8,4%	9.40%	8.4%	6.6%
PL (ish LSI)					3.40%	1.20%	2.10%	2,4%	2%	1.6%	0.9%

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Tjetër					0.70%	0.40%	0.30%	0,3%	0.20%	0.4%	3.1%
Jo					52%	58%	60%	58,8%	54.20%	56.6%	50.3%
A jeni anëtar i ndonjë partie politike?											
Po					16%	12%	13%	10,4%	12.5%	12.6%	
PS					6.90%	6.60%	4.60%	4,1%	4.6%	5.8%	
PD					2.60%	3%	2.90%	1,9%	2.6%	2.8%	
PL (ish LSI)					2.20%	0.80%	0.90%	1,1%	0.8%	0.8%	
Tjetër					0.60%	<0.1%	0.20%	<0,1%	0.2%	0.2%	
Jo					75%	81%	82%	81,2%	81.6%	74.8%	

2023 



INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

www.idmalbania.org